


Javier Cercas, një nga shkrimtarët më të rëndësishëm bashkëkohorë europianë, laureat i disa çmimeve jo vetëm në Spanjë, autor i më tepër se dhjetë librave përkthyer në disa gjuhë të botës, që në shqip ka ardhur nëpërmjet “Ushtarë të Salaminës”, “Mashtruesi” dhe “Monarku i hijeve” nën përkthimin e Bashkim Shehut, realizon këtë bisedë me Andreas Dushin, e para bisedë e tij për një medium shqiptar

## JAVIER CERCAS: Liria mund të mos na bëjë të lumtur, por sigurisht që na bën njerëz

Bisedoi Andreas Dushi



## PËRKUJTIMI I DITËS SHQIPTARË TË FOTOGRAFISË: 23.08.1863

Nga Besim Fusha

(fq. 6)

Fotografia që fillnisi artin fotografik në truallin shqiptar, fikson: “Nusja Shkodrane” e Jozef Szekeley, në Shkodër, më 23.08.1863. Është shkruar edhe në EXLIBRIS për këtë fillesë festive. Kemi përzënë Hamzë Kazazin, emëruar gabim për herë të parë nga Kel Marubi në një fotokartolinë (1936) shtypur në “Alterocca Terni” në Itali. Kështu Hamza, div i gjatë, sikur i shtriu këmbët deri në vitin 1856.

## NJË FOTOGRAFI ME KADARENË DHE KAPLLAN RESULIN

Nga Bujar Hudhri

(fq. 5)

Lajmi se në Gjenevë ka ndërruar jetë shkrimtari Kapllan Resuli më kujtoi një episod që nuk më hiqet nga mendja.

## PËRKTHIMI LETRAR: ARTI I TË PËRKTHYERIT TË EMOCIONEVE

Dr. Elda Katorri

Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali

(fq. 12)

## FOTOGRAFIA OSE DITARI I KOHËVE MODERNE

Nga Ina Kosturi

(fq. 6)

## LIBRI – URGJENCË KOMBËTARE, IDENTITETI YNË NË RREZIK!

Nga Xhevair Lleshi

(fq. 14)

## SHËNIME MBI LIBRAT

Shënime për vëllimin poetik “Në orën moderne të perëndive”

## RELIEVI POETIK I NURIE EMRULLAIT

Nga Ndue Ukaj

(fq. 21)

Rreth romanit të Fehmi Pireva, “Nëpunësi i Kuvendit”

## E KEQJA E ORGANIZIMIT TË SHTETIT

Nga Xhevat HALILI

(fq. 15)

## “RRUGËT E FERRIT”, ROMAN I VISAR ZHITIT, BOTOHET NË ITALI

(fq. 13)



## IN MEMORIAM

## PËR ARTISTIN DHE NJERIUN KRISTAQ DHAMO

Nga Enver Kushi

(fq. 10)



## JAN WALRAVENS: TAKIM ME RENÉ MAGRITTE

(fq. 22)

## BIBLIOTEKË

Ismail Kadare

(fq. 18)

*Shënime nga kapitaneria  
e portit*

Arthur Schnitzler

(fq. 16)

*Vallja*

Odise Kote

(fq. 11)

*Ti zbret si lumë...*

## DITËT POETIKE TË SETËS

nga Feride Papeleka

(fq. 20)

Mbi autorësinë e romaneve “Martesa e Lejlës”  
dhe “Sotiri e Mitka”

## HIPOTEZAT DHE SHPJEGIMET E FOTAQ ANDREAS

Nga Sevdai Kastrati

(fq. 4)

# JAVIER CERCAS:

## Liria mund të mos na bëjë të lumtur, por sigurisht që na bën njerëz

Bisedoi Andreas Dushi



Me sugjerimin e kolegut Liridon Mulaj, vendosa të provoj t'i bëj intervistë Javier Cercasit, një nga shkrimtarët jo vetëm spanjollë, por mbase europianë, më të rëndësishëm bashkëkohorë. E kisha lexuar prej disa vitesh librin e tij të parë, *Ushtarë të Salaminës*, botuar nga *Toena* fillimisht, nën përkthimin e Bashkim Shehut dhe Edlira Hoxhollit. Vite më vonë, edhe *Mashtruesi*, sërish përkthyer nga Shehu e me të marrë vesh se autori do të vinte në Tiranë, edhe *Monarku i hijeve*, tanimë botuar nga *Dudaj*. Stili i veçantë, loja e lirë me historinë dhe trillimin, ndërthurja e fakteve me përjetimet... Gjithçka që përbën atë letërsi të cilën veçanërisht pëlqej.

Fola me Bashkimin që me dashamirësi më prezantoi me Cercasin. Ky i fundit, paçka se ishte tepër i zënë, tha se *do të ishte i lumtur t'i përgjigjej pyetjeve të mia*. I kërkova disa ditë, rilexova librat e tij në shqip, i hodha një sy disa studimeve për letërsinë e tij botuar në revista letrare ku jam i abonuar dhe përgatita dhjetë pyetjet vijuese që ia nisa. Nuk vonoi shumë e erdhën përgjigjet. Në spanjisht, sigurisht. Miku im, Antonio Çikollari, gjithashtu edhe koleg në disa fusha e së fundmi në Bibliotekën Kombëtare ku punojmë së bashku, përkthyes i disa librave e krijimeve letrare, një pjesë të botuara edhe në "ExLibris", e përktheu intervistën që tanimë po botojmë, redaktuar paraprakisht nga përkthyesi i Cercasit.

Gjatë saj ka shumë momente kur thuhet fjali a shprehje që mund të shërbenin si tituj; ishte diçka vërtetë e vështirë përzgjedhja e një të tilli, por uroj *t'ia kem qëlluar*. Ndër të tjera, ai thotë edhe se letërsia është e dobishme, pohim që shpeshherë shihet si i tejkaluar, "i dalë mode"... Gjithsesi, nga Cercasi kam mësuar shumë, edhe nëpërmjet kësaj bisede. Nuk e di nëse edhe për ju do të jetë e tillë, por uroj që së paku t'ju tejojë një lloj këndelljeje, një lloj përjetimi të bukur estetik.

A.D.: Zoti Cercas, fillimisht, shumë faleminderit për këtë intervistë. Do të doja ta filloja me "Ushtarë të Salaminës", një libër që, qysh nga botimi i parë, është përkthyer në më tepër se 30 gjuhë, mes të cilave edhe ato më kryesoret. Çfarë mendoni për kalimin e një historie si ajo në aq shumë vende? A janë të gjithë ata vende gati "për ta përthithur" atë?


J.C.: E përse jo? Letërsia e kthen të veçantën në universale; diçka që i ndodh një plaku të çmendur në një fshat të vogël të Mançës letërsia e kthen në atë që na ndodh të gjithëve kudo që jemi. "Pikturo fshatin tënd dhe do të kesh pikturuar krejt botën", shkruan Tolstoi. *Ushtarët* flet mbi pjesën e luftës civile spanjolle – apo për atë çfarë ka mbetur prej luftës civile pas gjashtëdhjetë vjetësh – por, si çdo vepër letrare, ngre çështje universale që na shqetësojnë të gjithëve. Dhe për këtë arsye mendoj që librat e mi duhet të lexohen ngado.

A.D.: Letërsia juaj bën bashkë në të shkuarën, realitete e trillime. Si ia dilni ta ndërtoni në libër këtë raport kaq delikat, ç'është e vërteta?

J.S.: Trillimi i pastër nuk ekziston, por, edhe nëse do të ekzistonte, askush nuk do të kishte pikë interesi për të (ta themi shkoqur, as që do të ishte i kuptueshëm). Letërsia gjithmonë e përzien trillimin me realitetin; kjo nuk mund të bëhet në gazetari apo në histori, por letërsia e ka bërë gjithmonë, prej Homerit (veprat e Dantes, Servantesit, Shekspirin janë përplot me personazhe të vërtetë përzier me ato të trilluara). Dhe prandaj është interesante. Është e vërtetë që, tek *Ushtarët*, marrëdhënia mes realitetit dhe trillimit është e veçantë dhe tejet komplekse për ta shpjeguar këtu. Do them vetëm se, kur bëhet fjalë për

Historinë me shkronjë të madhe, i qëndro besnik realitetit në mënyrë skrupuloze, ndërsa, kur bëhet fjalë për historinë me

shkronjë të vogël (historitë personale, private, etj.), i shfrytëzoj të gjitha liritë që i konsideroj si të nevojshme dhe



shkruaj librin më të mirë të mundshëm. Historia apo gazetaria kanë kufizime, rregulla; romani, në krahasim tjetër, nuk ka kufizime; e thënë ndryshe: rregulli i vetëm i romanit është që nuk ka rregulla. Të tillë e shpiku Servantesi, romancieri më revolucionar që ekziston. Dhe i tillë do të mbetet.

A.D.: Ndihehi sikur lexuesi ju kupton përherë ju si shkrimtar?

J.C.: Lexuesi nuk ka asnjë detyrim të më kuptojë, ama unë kam detyrim të kuptoj veten time. Nuk e di nëse jam i qartë. Një personazh nga *Terra Alta* (romani i parafundit që kam botuar dhe i pari i një trilogjie, vëllimi i fundit i së cilës sapo ka dalë në spanjisht dhe italisht) thotë: "Gjysma e romanit është shkruar nga romancieri. E gjysma tjetër nga lexuesi". Kjo është një nga ato pak të vërteta absolute që unë di. Romani është si një partiturë dhe lexuesi është interpretuesi, çdo lexues e interpreton sipas mënyrës së tij; kjo është magjia apo pjesa më e madhe e magjisë së letërsisë. Ka një keqkuptim të madh: protagonist i vërtetë i letërsisë nuk është autori; është lexuesi, ai që i përfundon librat duke i përvetësuar. Kjo nuk do të thotë që leximet janë të gjithë të njëjtë; ka lexime të mira, të këqija dhe mesatarisht të mira, njëjtë si lexuesi (dhe autorët). "Libri është si pasqyra", shkruan Lichtemberg. "Nëse gomari shihet në të, nuk mund të presë të reflektohet si profet". Unë thjesht pretendoj të kem lexuesit më të mirë të mundshëm, sepse ata m'i përmirësojnë librat.

A.D.: Dhe rreth lirisë... Po jetojmë në një çast kritik, besoj, të këtij shekulli. Një pandemi, një luftë; frika është ngado... Këta elementë krijojnë një atmosferë ku njerëzit janë të frikësuar të jenë të lirë, pasi që mund të lëndohen. Ju keni shkruar goxha rreth lirisë dhe se, si një zgjedhje, ajo duhet të jetë **e domosdoshme**. Lidhur me çfarë po ndodh sot, si e shihni këtë?

J.C.: E shoh si gjithmonë, pasi qeniet njerëzore nuk ndryshojnë në thelb, megjithëse rrethanat në të cilat jetojmë janë të ndryshme (dhe prandaj sot ne mund të vazhdojmë të lexojmë Homerin, Danten, Servantesin si të ishin shkruar dje). Është normale që njerëzit të kenë frikë nga liria. Është një fjalë e urtë gjermane që thotë: "Wer die Wahl hat, hat die Qual", që do të thotë: "Kush ka zgjedhje, ka vuajtje". Kësaj mund t'i shtoj vetëm se kjo vuajtje është ajo që na dallon nga bishat dhe skllëverit; e thënë

ndryshe: liria mund të mos na bëjë të lumtur, por sigurisht që na bën njerëz.

A.D.: 16 vjet pas “Ushtarë të Salaminës”, ju erdhët me “Monarku i hijeve”. Kritika e ka quajtur si një “Libër luftë që është aq shumë anti-luftë.” Personazhi kryesor, një djalosh, një ushtar që lufton dhe vdes në anën e gabuar të historisë. Sërish, në kontekstin e sotshëm, mendoni se këto ushtarë që zgjedhin të shkojnë, luftojnë e ndoshta vdesin, do ta rimendonin këtë nëse do të lexonin këtë libër ose të tjerë si ky? Apo, e thënë më thjeshtë, dokumentimi i jetës së njerëzve si personazhi kryesor i këtij libri, mund t’i ndihmojë njerëzit sot të zgjedhin anën e duhur?

J.C.: Shpresoj që po (edhe pse nuk besoj se, për të gjithë lexuesit, të zgjedhësh mirë do të thotë të zgjedhësh të njëjtën gjë). Dhe për këtë arsye, në kundërshtim me atë që shpallet nga njëra prej bestytnive kryesore letrare të kohës sonë, besoj se letërsia është e dobishme; vetëm se për aq sa nuk ia vë qëllimin vetes që të jetë: sapo letërsia synon të jetë e dobishme, shndërrohet në propagandë apo në pedagogji; dhe aty resht së qeni letërsi – të paktën letërsi e mirë – dhe resht së qeni e dobishme.

A.D.: Mendoni se letërsia ka “një të vërtetë”? Nëse po, cila është ajo?

J.C.: Ekziston e vërteta e letërsisë, sigurisht, por nuk është si e vërteta e historisë apo e shkencës. E vërteta e historisë apo e shkencës është një e vërtetë konkrete, faktike, kërkon atë që u ndodh njerëzve të caktuar në një vend dhe në një kohë të caktuar; ndërsa e vërteta e letërsisë është një e vërtetë abstrakte, morale, universale: ajo kërkon atë që u ndodh të gjithë njerëzve, në çdo kohë dhe në çdo vend (kjo është arsyeja pse Aristoteli mendonte se e vërteta e letërsisë, të cilën e quajti besueshmëri, është superiore ndaj asaj të historisë mendoj se janë thjesht dy të vërteta të ndryshme). Kjo e vërtetë arrihet pothuajse gjithmonë përmes trillimit, që nuk është tamam gënjeshtër, por mjaft e ngjashme me të (prova është se, në latinisht, fjala “mentiri”, nga e cila e ka prejardhjen fjala spanjishtje apo ajo frëngjishtje “mentir” [të gënjeshtër] dhe italishtja “mentire”, do të thotë “gënjej” dhe gjithashtu “trilloj”). Kjo është e vërteta e thënë nga Don Kishoti, Hamleti apo Zonja Bovari. Është ajo që Mario Vargas Llosa e ka quajtur “e vërteta e gënjeshtërave”.

A.D.: Në Shqipëri, kryesisht, luftërat janë parë nga perspektiva e fituesve, e heronjve, veçanërisht për thujse 50 vjet kur ishim nën diktaturën komuniste, kohë në të cilën Realizmi Socialist ishte dogmë. Edhe tani, ndoshta në Kosovë mund të lexosh libra nga perspektiva e humbësve, por në Shqipëri është e vështirë të gesh. Por tek ju, shumica janë pikërisht këto heronj, më shumë si antiheronj, rreth të cilëve ju shkruani. Pse?

J.C.: Nuk e di. Unë s’i zgjedh subjektet: subjektet më zgjedhin mua. Unë shkruaj për obsesionet e mia, të cilat janë irracionale. A janë heronjtë e mi antiheronj ngaqë tek e fundit triumfi më



duket vulgar dhe disfata më duket fisnike; ngaqë ndiej se asgjë s’mund të mësohet prej fitores, ndërsa prej dështimit, po; ngaqë më bëhet se triumfi është gjithmonë një formë dështimi, ndërsa dështimi është pothuajse gjithmonë një formë triumfi? Ndoshta. Por, e theksoj: nuk e di. Ajo që di është se, siç thashë edhe më parë, letërsia pedagogjike – një nga format e së cilës ishte Realizmi Socialist – më duket letërsi e keqe: në fakt, për mua shprehja “letërsia pedagogjike” është një oksimoron, ashtu si shprehja “martesë e lumtur”.

A.D.: Enric Marco, një mashtrues që pretendon të ketë qenë i burgosur në Mathausen, shkak për të cilin mori gjithë lavdinë... Personazhet tuaja, sikurse e thashë, zakonisht vijnë nga e shkuara, por me të bëni një përjashtim, pasi ai ishte akoma gjallë kur libri u botua. Pse e zgjodhët atë?

J.C.: Të shkruarit e një romani konsiston, për mendimin tim, në formulimin e një pyetjeje komplekse në mënyrën më komplekse që mund të bëhet; dhe të mos i përgjigjesh, të

paktën jo në mënyrë të qartë, shteruese, taksative: përgjigjet në romane janë gjithmonë komplekse, të paqarta, kontradiktore, në thelb ironike: thellë-thellë, përgjigjja është vetë kërkimi i një përgjigjeje, vetë pyetja, vetë libri. Në rastin e “Mashtruesit”, pyetja që i bëra vetes është e trefishtë. Së pari: si është e mundur që një njeri të gënjejë për krimin më të tmerrshëm në historinë e njerëzimit? Së dyti: si është e mundur që e kanë besuar të gjithë, që askush nuk i ka vënë në dyshim gënjeshttrat e tij, që ai u shndërrua në një hero të vërtetë civil dhe në zërin e viktimave? Së treti (dhe ndoshta më e rëndësishmja): pse më prek kaq shumë demaskimi publik i mashtrimit të jashtëzakonshëm i këtij njeriu? Libri, e theksoj, është një përpjekje për t’i formuluar këto tri pyetje në mënyrën më komplekse të mundshme dhe rezultati është, ndër të tjera, një reflektim mbi gënjeshtren dhe aftësinë tonë të pafund për të mashtruar veten.


A.D.: Si mund ta shpjegoni veten mes një profesori letërsie dhe një shkrimtari? Është e vështirë të flasësh e studiash

autorë të tjerë dhe, a është 100% e mundur të jeni objektiv në të?

J.C.: Nuk jam profesor letërsie: kam reshtur së qeni i tillë vite më parë, sapo fillova ta fitoja jetesën me librat e mi, gjë që nuk e kisha menduar kurrë se do të ndodhte. Për mua, universiteti ishte thjesht një punë për t’u ushqyer: asnjëherë s’kam qenë nga ata profesorë që shkruanin herëdokur ndonjë roman, por një romancier që e siguronte jetesën duke punuar në universitet. Vokacioni im nuk ishte mësimdhënia: ishte letërsia. Sa për të tjerat, më duhet të them se edukimi im si filolog ka qenë themelor për romanet e mia dhe se nuk më pëlqente fare të jepja leksione dhe nuk më dukej aspak e pajtueshme me të shkruarit (edhe pse do të gënjeja po të thoja që më merr malli).

A.D.: Dhe së fundmi, një pyetje që gjithnjë ja kam bërë vetes, ndoshta feminare, por mos më gjykoni. Për shkrimtarët spanjollë, “krijues” të gjuhës spanjolle, si ishte kur, në shekullin XX, shkrimtarë nga vendet e Amerikës Latine me këtë gjuhë, që vinte nga atdheu i shkrimtarëve spanjollë, Spanja pra, u bënë shumë më të famshëm se ata? Ndoshta as që e kishin problem, nuk e di, por vërtetë dua t’ju pyes për këtë.

J.C.: Unë nuk jam shkrimtar spanjoll: jam shkrimtar që shkruan në spanjisht. Dua të them se kam fatin e jashtëzakonshëm që tradita ime letrare është pasuruar në mënyrë të pashtershme gjatë shekullit të kaluar falë prozatorëve dhe poetëve të mëdhenj latino-amerikanë. Për mua është fat që i përkas traditës së Borgesit, Vargas Llosas, Garsia Marquezit, Rulfos ose Nerudës dhe që jam në gjendje t’i lexoj këta autorë në gjuhën time; ndër të tjera, sa më shumë pasurohet tradita gjuhësore, aq më shumë instrumente kemi për të shkruar. Dhe besoj se është e mrekullueshme që janë shkrimtarë shumë të njohur: e meritojnë. Çdo gjë tjetër më duket krejtësisht e parëndësishme.



(vijon nga numri i kaluar)

Ndonëse studimet mbi Konicën ngjatë këtij shekulli janë pafund deri në ditët e sotme, prapëseprapë asnjëri nga studiuesit nuk është rrekur të bëjë një krahsim të kujdesshëm me argumente bindëse nëse Faiku ynë është pagëzuar në 'katolik'.

Ndër studiuesit që janë marrë me çështjen e pagëzimit të Faik Konicës, ndër të cilët veçoj Thanas Gjickën, i cili është i pari që ka bërë një përpjekje me shkrimin Sikur ta kishim dëgjuar Faik Konicën! (Ecuria e mendësisë fetare tek shqiptarët, në 115-vjetorin e pagëzimit të Faik Konicës). Th. Gjicka supozon se "pagëzimin e Faik Konicës me emrin Domenik e dëshmojnë edhe disa letra të viteve 1895-97, dërguar shqiptarëve të Bukureshit". Veçse për këtë pohim (edhe pse pa kurrfarë hollësisë) nuk jep tjetër argument dhe na shtynë të mos pajtohemi me mendimin e tij. Ashtu siç nuk mund ta besojmë edhe thirrjen kinse Konica i ka bërë Murat Toptanit<sup>9</sup> për t'u bërë 'katolik', sepse është vetëm një pohim i Th. Gjickës pa asnjë referencë të burimit që ka shfrytëzuar. Po në këtë shkrim të Gjickës argumentet janë mjaft të cekëta dhe nuk sjellin asgjë të re për ndriçimin nëse Faiku vërtet është pagëzuar në 'katolik'.

Ndërkaq, në gjurmët e Gjickës ecën edhe F. Andrea kur (pas një punë të gjatë e të mundimshme kërkimore!!!) 'zbulon' se pagëzimi mund t'i përkasë vitit 1894 dhe jo siç thotë Th. Gjicka, vitit 1895. Madje, duke shkuar tek kësaj hamendjeje nuk ngurron të pohojë se emri i pagëzimit është Dominik dhe jo siç thotë profesori i tij me emrin Domenik. Në fakt e korrigjon Th. Gjickën, i cili është përkrahësi kryesor i hipotezës se romanet janë të Konicës, me qëllim që personazhi Dominik të jetë i ngjashëm me emrin e pagëzimit të Faikut gjoja në katolik. Në këtë rast i jap të drejtë F. Andreas se personazhi i romanit është me emrin Dominik (Dominique).

Sa i përket çështjes së pagëzimit të Faik Konicës në 'katolik' shkruesi këtyre radhëve ka një sërë arsyesh të mos pajtohet me mendimet e studiuesve të lartpërmendur:

a) Dëshmia e Faik Konicës, i cili në shkrim Ç'është liria?<sup>10</sup> thotë: "Janë Shqipëtarë qi kanë fe. Unë u thom: "ata janë të lirë të kenë fe, janë të lirë të thonë që kanë fe, janë të lirë të shkrojnë që feja është e mirë, janë të lirë të bëjnë ç' urdhërojnë feja"; dhe kur më dërgojnë artikëlla për të lavëduar ferat, i shtyp pa besuar, se s'kam të drejtë t'u pres lirin' e fjalës. Po kur unë besonj, thom, shkronj që më vjen të vjellur për ç' do fe, - ata shpirtrobërit më thresin: "S'të lëshojmë lirinë të shaç ferat!" S'më lëshoni të shaj ferat? Por unë, shpirtrobër, pse u lëshonj t'i lëvdoni ferat ato? A kini, në mos fillosofi, pakëzë mend për ta kuptuar që fjala juaj është fjalë gomari?";

## Mbi autorësinë e romaneve "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri e Mitka"

# HIPOTEZAT DHE SHPJEGIMET E FOTAQ ANDREAS

### Nga Sevdai Kastrati

Ndërkaq, në gjurmët e Gjickës ecën edhe F. Andrea kur (pas një punë të gjatë e të mundimshme kërkimore!!!) 'zbulon' se pagëzimi mund t'i përkasë vitit 1894 dhe jo siç thotë Th. Gjicka, vitit 1895. Madje, duke shkuar tek kësaj hamendjeje nuk ngurron të pohojë se emri i pagëzimit është Dominik dhe jo siç thotë profesori i tij me emrin Domenik. Në fakt e korrigjon Th. Gjickën, i cili është përkrahësi kryesor i hipotezës se romanet janë të Konicës, me qëllim që personazhi Dominik të jetë i ngjashëm me emrin e pagëzimit të Faikut gjoja në katolik.

b) Kryepeshkopi ynë Theofan në ditën e varrimit të Faik Konicës nuk bërë ndonjë cermoni fetare: përpos fjalimit të përzishëm që mbajti në shqip dhe anglisht e përcolli mikun e tij të shtrenjtë për në banesën e fundit me muzikë nga Wagner, kompozitori i adhuruar i të ndjerit;

c) Dëshmia e Fan S. Nolit, i cili në shkrimin Flet Faik Konica<sup>11</sup> kinse e shkruar në Romë më 15 shtator 1945 dhe i fshehur pas pseudonimit Robo Rogozhina thotë se "Faiku, në

djalëri kishte kaluar nëpër të gjitha ideologjitë revulucionare, dhe jo për cipë a shkel-e-shko, po kishte hyrë thellë, dhe i kishte shtudiuar me zjarr e pasion... Po t'a kruanje pak, menjëherë çfaqej revulucionari i vjetër";

d) Përsëri kemi edhe një dëshmi tjetër nga Imzot Noli kur flet në lidhje me vendin që zë Konica në historinë e re të Shqipërisë: "Si mysliman dhe me prejardhje nga një familje e vjetër aristokratike e Shqipërisë së Jugut, Konica i kishte të gjitha rrugët e

hapura për të arritur pozitën më të larta të Perandorisë turke, në të cilën Shqipëria bënte pjesë që nga vdekja e Skënderbeut. Për shembull në kohën, kur Konica ishte ende i ri, Veziri i madh ose Kryeministër i Perandorisë turke ishte Ferid Pasha, një shqiptar nga Vlora. Por kjo rrugë për të bërë karrierë nuk e tërhiqte Konicën. Ai mendonte se misioni i tij ishte që të luftonte për pavarësinë e Shqipërisë"<sup>12</sup>.

Përpos fakteve të lartpërmendura mund t'i shtojmë dhe disa të dhëna të tjera për të mbështetur hipotezën tonë:

Është thënë se Faiku në Paris u përzi me qarqet socialiste revolucionare dhe për një kohë bashkëpunoi me disa gazeta ekstreme të Parisit.

Është thënë se Faiku në rini ishte një anarkist revolucionar dhe njëherit ishte redaktor i një gazete anarkiste me titullin Le Scandale.

Në këtë rast do të ndalemi edhe në disa të dhëna që na ofron vetë Faiku gjatë qëndrimit në Amerikë:

Në javën e parë të dhjetorit (1912) gazeta "Herald" e Bostonit e quan Faik Konicën socialist dhe përkthyes të Kuranit.

Dhjetë vjet më vonë (janar 1922) gazetën greke të New York-ut e akuzojnë Faik Konica kinse e ka përkthyer Kurandin në shqip, me qëllim që të ndez fanatizmin e shqiptarëve myslimanë. Në të vërtetë Kurani është përkthyer dhe është botuar prej shqiptarit ortodoks Ilo Mitkë Qafzezi më 1921 në Bukuresht. Në parathënie Qafzezi bën me dije se "e përktheu nga dëshira për të dijtur se cila është ajo 'cipë qepe' misterioze që i ndan fetarisht shqiptarët myslimanë nga vëllezërit e tyre të krishterë".

Është fakt në anën tjetër se Faik Konica i ka bërë thirrje shqiptarëve myslimanë për t'u kthyer në krishterizëm ose për t'u bërë gjysmë të krishterë me qëllim që të ndalohet copëtimi i Shqipërisë: në mos idealismi, të pakën buka dhe detyra që kini te fëmija juaj ju shtrëngon të bëni nga dy gjëra një: a të kthehni te feja e stëgjyshërve t'uaj, a të mbeteni muhamedanë, po duke u lidhur me aqë vërtetësi dhe zemrë me të krishterët nga gjaku juaj sa t'i jipni kombit t'uaj një karakter gjysmë të krishterë.

Po kështu edhe tre vjet më vonë, më 5 dhjetor 1912, Faik Konica do ta kundërshtojë kandidaturën e Kolonisë së shqiptarëve të Misirit për të përkrahur Ahmet Fuatin për fronin e Shqipërisë:

Pa mohur cilësit' e njeriut, të cilin as që e kishim dëgjuar më parë; pa vënë re që ka të ngjarë se munt të zgjidhet, si i pëlqyer nga Austria, i përkrahur nga fanatizmi i fshehur i Muhamedanëve, dhe nga moskuptimi a ftohtësia e të krishterëve: - unë, Faik Kontza, protestoj kundër zgjedhjes së një princi musliman për fronin e Shqipërisë, edhe u lutem bashkatdhetarëve të mij të mos bëjnë që në krye një lajthim politik të



trashë, i cili do të vërë tërë të pritmen e Shqipërisë në rrezik.

Me këtë rast Konica do të shtjellojë katër argumente:

Zgjedhja e një princi mysliman në fronin e Shqipërisë është e dëmshme në pikëpamje politike, sepse Shqipëria në botën e qytetëruar do të konisderohet shtetet orientali si Bukhara, Khiva, Afganistani, Tunezia. Me një një fjalë do të jetë një Turqi e dytë dhe do ta përdorin fqinjët si të duan.

Zgjedhja e një princi mysliman në fronin e Shqipërisë është e dëmshme në pikëpamje administrative, sepse Shqipëria do të qeveriset sipas metodës së vjetër. Pra, duhet e sotmia të prit nga e djeshmja dhe të bëhemi një komb europian i përparuar.

Zgjedhja e një princi mysliman në fronin e Shqipërisë është e dëmshme në pikëpamje mendore, sepse Shqipëria s' do të ketë shpëtim nga medresetë dhe Anadulli.

Zgjedhja e një princi mysliman në fronin e Shqipërisë është e dëmshme edhe në pikëpamje morale, sepse Shqipëria do të jetë e mbuluar me një ngjyrë anadollake. "A e dini – pyeste Konica - ç' do me thënë një mbret muhamedan – osë, që të flasim të vërtetën, një emir, një khediv, a një kahn, i Shqipërisë? – Do me thënë që Pallati do të ketë të pakën disa duzina gra, kafase në penxheret, Arapë të tredhur, edhe gjithë intrigat e zakonëshme të Haremit".

Në fund Konica shpreh besim se shqiptarët që ruajnë aq bukur nderin dhe paqësinë në vatrat e tyre, s'kanë as nge as dëshirë për të tilla zakone.<sup>13</sup>

(vijon në numrin e ardhshëm)

<sup>9</sup> "Mbas pagëzimit, Faiku i propozoi mikut të tij të ngushtë, Murat bej Toptanit, të pagëzohej dhe ai dhe të dy së bashku të nxisin miq e shokë të tjerë për t'u pagëzuar edhe ata. Mirëpo Murati iu përgjigj se nuk mund ta bënte një hap të tillë, mbasi vëllezërit Frashëri, tek të cilët ai ishte dhëndër, do ta dëbonin nga shtëpia": Thanas Gjika, Evoluimi ynë kërkon njohjen dhe dënimin e fajit (Artikuj, portrete, letra, kujtime), Botimet DDS, Tiranë, 2011, f. 56-57.

<sup>10</sup> Shih Robo Rogozhina, Flet Faik Konica, "Dielli", Boston, 28 nëntor 1945, nr. 5698, f. 2.

<sup>11</sup> Faik Konica, Ç'është liria?, "Albania", Bruxelles, 1897, nr. 2, f. 32.

<sup>12</sup> "As a Moslem and as a descendant of an old aristocratic family of Southern Albania, Konitza had every chance to obtain the highest offices in the Turkish Empire. For instance, in Konitza's youth, the Grand Vizier or Premier of the Turkish Empire, Ferid Pasha, was an Albanian from Valona. But that kind of career did not appeal to Konitza. He thought that his mission was to fight for the independence of Albania": shih Introduction by Bishop F. S. Noli, në: Faik konitza, Albania: The Rock Garden of Southeastern Europe and Other Essays, "Vatra", Boston, 1957, f. xxi-xxii.

<sup>13</sup> Faik Konica, Një problem i rëndë – të zgjidhurit e mbretit. "Dielli", Boston, 5 dhjetor 1912, nr. 178, f. 1.

# NJË FOTOGRAFI ME KADARENË DHE KAPLLAN RESULIN

*Nga Bujar Hudhri*

**L**ajmi se në Gjenevë ka ndërruar jetë shkrimtari Kapllan Resuli më kujtoi një episod që nuk më hiqet nga mendja.

Ishim në panairin e librit në Ulqin dhe atëbotë i ftuar nderi ishte Kadare dhe zonja e tij, Helena. Duhet të ketë qenë viti 2003, mbase.

Pas stendës Onufri, ku Kadare qëndronte gjithë kohën duke dhënë autografe, ishte një stendë e veçuar, e cila kishte vetëm tre libra, ku titujt lexoheshin qartë edhe nga larg: Kapllan Resuli - "Fytyra e vërtetë e Kadaresë", i botuar në tri gjuhë, shqip, frëngjisht dhe serbisht.

Dhe pranë kësaj stende ishte ulur një burrë i qetë, që nuk fliste asnjë fjalë dhe pothuaj nuk lëvizte fare nga vendi, si një statujë.

Ishte Kapllan Resuli, autori i librit, dora vetë!

E kisha parë vetëm në fotografi, megjithatë nuk e pata të vështirë ta njihja, por çuditërisht nga afër m'u duk shumë paqësor. Mbase përfytyrimi im lidhej me gjithçka dija rreth jetës së tij të vështirë si edhe nga shkrimet e tij të egra kundër Kadaresë në shtypin serb, sa herë që vinte tetori i Nobelit.

Ja pra, ishin kaq afër, pothuaj dy metra, Kadare dhe Kapllan Resuli. Madje, dukeshin edhe më afër sepse te stenda e Kapllan Resulit nuk vinte asnjë vizitor, ndërkohë që te Kadare nuk kishte të mbaruar radha e gjatë e lexuesve që kërkonin autograf.

Ishte një pamje shumë e bukur, po ta kundroje nga larg. Dielli po perëndonte, rrezet e tij të binin në sy nëse do të doje të bëje fotografi. E ndieja këtë, sepse sa herë lexuesit donin të bënin foto, Kadare bezdisej gjithmonë dhe vinte pëllëmbën e dorës për t'u mbrojtur nga rrezet.

Pikërisht, në këtë kohë, një zotëri, që sapo mori

autografin nga Kadare, m'u drejtua gjithë respekt: a mund t'i thuash Kadaresë vetëm sa ta përqafoj një herë.

Duke e ditur se sa bezdi i ka Kadare këto sjellje, këmbëngula se nuk kishte kuptim që dy burra të përqafohen. Po mirë, më tha, një foto atëherë, mos më kundërshtoj.

Iu luta Kadaresë dhe gjithë përtim ai pranoi.

Mora aparatën e zotërisë dhe duke u munduar t'i fokusoj sa më mirë, (Kadareja ishte ulur në karrike) kur ç'të shoh: në sfond, kurrë nuk kam për ta harruar, midis të dyve, zuri vend koka e Kapllan Resulit dhe libri i tij kundër Kadaresë.

Pasi ia ktheva aparatën fotografik, zotëria shkoi dhe u ul te stenda e Kapllanit dhe po i tregonte atij foton në aparat.

Seç biseduan me njëri tjetrin nuk e mora vesh.

Por, u bëra shumë kureshtar dhe vajta drejt e te stenda dhe e pyeta se kush ishte:

-Unë jam vëllai prej nëne dhe prej babai i këtij burri. Ne jemi rritur me veprat e Kadaresë. Gjithë jetën. Gruaja ime e ka dhënë mësim, se është mësuese e letërsisë, ndërsa vajza studion letërsi në universitet, në Podgoricë.

Duke parë hutimin tim nga që nuk munda t'i them asnjë fjalë, më tha gjithë trishtim:

-Kapllani ka qenë shkrimtar, gjithë jetën e ka dashur Shqipërinë, por Shqipëria juaj e kalbi në burg! Ia gjymtoi jetën, deri sa e çmendi fare!

Ndenjëm të heshtur të tre njëfarë kohe.

Ndërkohë Kadare përballej me vargun e pafund të lexuesve, tashmë rrezet e diellit në perëndim skuqnin qiellin mbi kullën e Balshajve.



Fotografia që fillnisi artin fotografik në truallin shqiptar, fikson: “Nusja Shkodrane” e Jozef Szekely, në Shkodër, më 23.08.1863. Është shkruar edhe në EXLIBRIS për këtë fillësë festive. Kemi përzënë Hamzë Kazazin, emëruar gabim për herë të parë nga Kel Maubbi në një fotokartolinë (1936) shtypur në “Alterocca Terni” në Itali. Kështu Hamza, div i gjatë, sikur i shtriu këmbët deri në vitin 1856. Dhe u la bindshëm në gënjeshtëri vite pa numërim... Deri kur u zëvendësua nga italianin (i vërteti brenda veshjes popullore shkodrane): *Alessandro De Rege di Donato* – konsulli italian në Shkodër (1881-1886), fotografuar nga Pietro Marubbi, në mjediset e arrira tashmë të ateliesë edhe për fotografi... Pra, mbi vitin 1880.

Prof. dr. Ferid Hudhri, në Enciklopedinë “Shqiptarët në artin botëror”, botim i Akademisë së Shkencave Shqiptare (2019), format madhor 25x33 cm., peshërendë me afro nja 600 faqe... – zbulon një të vërtetë që vlen të përsëritet: “Një pamje fotografike nga Durrësi” – më 1862. Nga fotografi anglez Francis Bedford. Që udhëtoi me jahtin mbretëror “Osborne”, për të shoqëruar princin e Uellsit, rinorin Albert Edëard, që më vonë u bë mbreti Edward VII i Anglisë. Do respektuar kjo ndodhi. Edhe pse nuk e ka peshën krahasues me rastësitë e thëna këtu. Ngase, kjo rastësore sidosesi nuk e zbeh dhe as nuk e madhon veten mbi ç'bënë e ç'sollën Pietro Marubbi dhe Jozef Szekely... Jo vetëm kaq. Tregon edhe punimet për punime fotografike qëllimore, për nevoja shkencore, ase sheti turistike... qenë sipërmarrje të lodhshme, me shumë mbingarkesa. Qenë luks që shënonte veçanti rastësore... Pietro Marubbi, arkitekt, inxhinier, piktor – iu shmang përndjekjeve mbas atentatit të Kryebashkiakut të Piacencës... - përfundoi rastësisht në Shkodër... - iu ngjit Kalasë Rozafa të takonte Guvernatorin... - takoi Ismail Haki Pashën, për ndonjë mundësi “punësimi”, dhe... Kishte takuar Guvernatorin me emërim provizor dhe gjeneralin pasionant të bukurisë së artit... Guvernatori – gjeneral u krekos përpara djaloshtit Pietro... Iu dorëzua si pozant i ngeshëm... Dhe në fund, kundroi i kënaqur. Pa edhe dora e djathtë qe paksa e shkurtër... - ia tha edhe djaloshtit. Nuk i pëlqeu shkurtia e dorës së djathtë... - e tha qortimin, por boll... – ngase e ndau mendjen se italianin i duhej Shkodrës dhe hobia të tij.

Guvernatori i mirë, plot bindje i dha të drejtën për një “SHTËPI ARTI”... Ndodhi në pranverë të vitit 1855. Ismail Pashën e Pietro Marubbi, nafaka – s’di se si, e solli përjetësisht si pronësi të GKA.

\* \* \*

Dikur kam thënë... nëse intuïta të rrek e lodh, ta mbërthen hamendësinë dhe, të ta përshfaqë dukshëm ç’fshihte, hidhesh gufant i lumturuar, fitimtar dhe Zot. Ndien gurgullimë nga brenda, një si melodi pëlqyese, një si ngopje shpirti, ta gris tymnajën dhe, në pamjen plot kthjelltësi, shpejton ta kapësh ç’kërkoje... Ja pra sesi: intuïta cytëse më pat pëshpëritur paprerë: *...ka ndodhur një mrekulli!* Qenka ndalun çasti i ecunisë shkodrane. Me artin më të ri qenka ndalun: *fotografinë*... Për herë të parë qenka ndalun – në Shkodrën time. Ndër të parat herë qenka renditur – krahasuar edhe me botën tejutje... e paska ndalun Jozef Székely... hungarezo-austriaku, vjenez, i caktuar me detyrën për ta ndalun. E paska ndalun për së pari jetësinë shkodrane, pa hile, pa mbrapakode... - kështu e paska ndalun. Pa faj e pa gabime. E paska shënuar çastin e ndalun... E paska shënuar e vulosun adresimin dhe kohën ... *Shkodër, fundgushti 1863*. Adresime pa të cilat fotografia e

# PËRKUJTIMI I DITËS SHQIPTARE TË FOTOGRAFISË: 23.08.1863

nga Besim Fusha



1. Nusja shkodrane... Foto: Jozef Székely – 1863. Fundgushti – 1863. E djelë mbasdreke, 23.08.1863. Çastfillesa fotografike mbi truallin shqiptar...

humbet memorien... çorodit dhe lodh përtej kohës. E paska angazhuar AAS (Akademia Austriake e Shkencave), dhe kjo shty tutje rastësinë... kjo rrezon e duk parësinë dhe, gjithsesi, duk interesin për Shqipërinë time. Vendi dhe datimi adreson dhe saktëson kohën e ngjarjeve. Mbi truallin e shqipes, kësohere, rendit e vulos fillësat fotografike.

Dhe, fillësa fotografike mbi truallin shqiptar ndodhi më 1863. Fundgushti, 1863. E diel, pasdreke, 23.08.1863.

Ndodhi herët, më saktë, njëkohshëm me botën fotografike të specializuar, që pat nisun të derdhej anembanë globit... ndodhi: kur, sosi në Kinë... asohere kur, amerikani Milton Miller, hapi *studio* (ateliën) e parë fotografike në Hong-Kong (1860). Kur fotografia eksperimentale e nisi të ngutej edhe për në skutat e ngjarjeve, si fjala bie, punë ditësh, nja një muaj para Székely në Shkodër – korrik 1863 – dhe ca më pas, amerikani Timothy H. O’Sullivan, fotografonte të pajetët e fushës së të vdekurve në Gettysburg, Pennsylvania... thënë më adresuar për shqiptarët: të vranët e Luftës së Madhe Civile, amerikane. Luftë

fotografoi zyrtarisht në Shkodër edhe kur, Julia Margaret Cameron, gruaja e parë – me parësi të namshme edhe mes burrash kështu – kulmonte e ngjitej në shkallët e namit artistik me pamjet: “*Mary Hilliet, Elisabeth and Kate Kuhn*” apo “*Paul and Virginia*” (1864), apo... (?) Jozef Székely fotografoi artistikisht në Shkodër, asohere kur, mjeshtri i madh Nadar (Gaspard Felix Tournachon), guxoi të fotografonte së pari që nga ballkoni (1858), “*Gruaja me kostum*” (1865), portretizoi, kohëshpërndarë në ato vite, serialin e madamave parisiane: Lafange, Delna, Jeanne Harding, ku do të veçojmë Georges Sand (Zhorxh Sand)? portretizuar më 1860-n gruan e manshme burrëruar me pseudonim ... Mbase për të duk lirinë e zaptuar a për të *fshëhun* nëpër romane dashunitë vetjake, me Shopen, Alfred de Muse, a kudiunë ... Dhe, dua të jeni të bindun se, mjeshtri Nadar atje në Paris, nuk i portretizoi parisienet? dhe as të veçantën Georges Sand? hiç më mirë e më bukur sesa dr. Jozef Székely këtë shkodranen time, këtu ...

\* \* \*

Përse duhet t’i rithoja – ç’thashë dikur?! Ngase fotografia e macahershme donte domosdo kohëgjatë të arrihej. Le të ripërmendim fotografinë e parë të presidentit amerikan Abraham Lincoln (1864), kur Matu Brani-t iu deshën pesë minuta për ta “ngrirë” palëvizshëm burrin e namshëm, mbërthyer me paftë mbrapa veshëve... Madje, edhe disa herë nga pesë minuta. Nga ku mezi u arrit i saktë vetëm një negativ i xhamtë. (Le të themi edhe, mbas stampës së parë, opaku i vtëm pozitiv, negativi i xhamtë u thye. Dhe, për t’u arritur shumimi i fotos dhe përjetësia e monumentit të presidentit, ulur patundshëm në korridorin e kryegodinës amerikane, nuk di se me ç’siklete mund të arrihej pa ate foto...)

Sidosesi, unë, përgjegjësi për ilustrimet e botimeve Enciklopedike në Akademinë shqiptare të Shkencave duke fillnisur më 1983 – rrjedhimisht, edhe kërkesa e herëherëshme e formuluesve europianë për saktësimet në ecuninë e fotografisë edhe shqiptare, më detyruan përgjatë për të ndrequr çqë gabim...

Një rinor plot energji, që hedh revolen... dhe lartohet vrik nga trazimet kulm për një tjetër Itali... – përfundon në Shkodrën me plot penela arti, thajse si bota... – vjen me duart e rrasuna në xhepa, krejt ndryshe nga Rozhe Fenton, që në njëjtën kohë (mesi i viteve 1850)... ngarkoi gjysmën e vaporrit në Balaklava për të fiksuar tmerret e heshtjes... pra, të shtrirët e vdekur në luftën e Krimesë... nga ku fotografia tronditi botën... – asohere pra, një djalosh simpatik dhe i mençur si Pietro Marubbi, nuk u kujtua t’i kërkonte Guvernatorit “SHTËPI FOTOGRAFIKE”... – por “Shtëpi arti...” – ngase qe piktor, arkitekt, inxhinier... – siç koha tregoi të shoqnohej me avranitasin Arsen Idromeno (babai i Kel Idromenos) ardhur nga Korfu... – dhe, koha i puqi për të ndërtuar “Pedonalen e Shkodrës”... – që edhe sot e për mot, do të mbetet veçantia e qytetit... Le të shembullojmë edhe me ç’përmend i nderuari Ferid Hudhri, anglezin Francis Bedford, që fotografon tri objekte të fiksuar në Durrës, me plot nge e bollëk mbretëror, nja shtatë a tetë vjet mbas gjoja Hamzë Kazazin... – djaloshi simpatik Pietro Marubbi, po ta dinte këte, do ta shëmtonte keqas fytyrën nga habia...

\* \* \*

Ja pra ç’tha *scripta manent*... Pietro Marubbi nuk e ka takuar kurrë Hamzë Kazazin... Hamzë Kazazi nuk është burri i

fotografisë së servitur si emblema e fillësës shqiptare... shënuar më 1856. Jo! Hamzë Kazazi u arrestua në Shkodër dhe u burgos nga turqit në Stamboll, pa ardhur akoma Pietro Marubbi në Shkodër. "Rebeli" Hamzë, u lirua nga burgju në fund të vitit 1859. Dhe, nuk arriti në Shkodër. Vdiq në Bushat, më 07.12.1859. Është thënë se qe i helmuar... Guri madhor i varrit që identifikon Hamzë Kazazin, u gdhend ngeshëm në osmanisht, në ditët e vitit 1860. Nafaka e shtyu dhe përcolli memorialin me vlere, deri në oborrin e Muzeut Historik të Shkodrës, në ish shtëpinë e të shumënjohurit Oso Kuka. Ku, sot e përjetë "mburrecet" si i vetmi identifikim për kryepolicin rebel të kryeqendrës së vilajetit, të Shkodrës. Identifikim pa fotografinë e të Zotit – ama!... Edhe *pjella* e dytë, medemek vendi i argjendit (?): Leonardo de Martino, nuk është fotografuar më 1859. As më 1856 dhe as më 1859... Kot!... Asnjëri! Nuk ka *Adamë* që rreken të shqyejnë brinjë për bijësimë e vijimësi të fotografisë shqiptare... Ka *Eva*... *Eva* plot vixhut dhe sharm Shkodre, që *fatnolli* Pietro-n dhe *tanë* Marubbët vlerëflori... Shkruetarët e mençun të shqipes cytëse *n'andrra t'hjedhta*... – shkruetarët edhe të Shkodrës së namshme - mbase, s'do të përshpejtonin që ta thonin si e thanë, po qe se nuk do t'i trysnonte vetçensura që gatoi çensura e madhe... U tha si u tha, ashtu përngutun, dhe u la... pra: mbeti pa ndreqie edhe për shkruetarët që pasuan. Përfshirë edhe të madhin Ismail Kadare.

\* \* \*

**Leonardo de Martino (1830-1923)**

... nuk është e vërtetë që emblema – e argjendit – e dyta në radhoin e fillësës së fotografisë shqiptare - mbetet Leonardo de Martino. Leonardo po, por kurrsesi jo imazhi "i cunguar" që serviret, i datuar më 1859. Më 1859... (?) nuk është e vërtetë. As në radhën e dytë! Nuk e ka vendin aty. Jo mbas të sajuarit Hamz Kazazi se, edhe ai, vendohet pasaktë në qoshen e tjerakuj... Fotografia portretprofil e Leonardo de Martino-s, e poetit arbëresh, të palartuar ende për aqsa çka vlera dhe hak... në të tjera qoshe e fsheh të vërtetën. Ne (po them versnikët e mi), nuk do ta njihim Leonardo-n tonë, po qe se nuk do të lindte dhe ecte gjallshëm fotografia. Po qe se Leonardo, nuk do të vulohej, gjithsesi si objekt dhe dëshmi në fillësën fotografike shqiptare. Nuk duhet thënë se kjo përmendje ose vaki, përkimi a caktimi kështu pra, synoi diçka me paramendim e dashje të qëllimtë. Nuk synoi, po themi, për të cikun dhe fshehun Loenardo-n Pra: si për ta mbajtur disi si dukshëm De Martino-n, disi si gjallë, diku në terr e pavarrosun, ndryshe nga ç'u përcudnuua dhe terrësua nxënësi i tij At Gjergj Fishta, fjala bie. Me Leonardo-n ngjau paksa ndryshe. Përjetoi diçka, edhe pse krejt flu e si nëpërgjumshëm, në memorjën e njerëzve të dheut që, gjithsesi, e deshën si kushedikushi..! U formësua disi pa përcaktuar, thujse pa e njohur, veçse: ashtu nëpërtymshëm, madje edhe hiç pa pyetun se ç'qe e ç'meritonte burri nën veladon. Nën veladonin ngjyrërrafsh, pa hiç thyerje e mëdyshje, pa kurrfarë medalje, nën rrobën që sajoi paprerë pluhurnajë e fshehu vlere në heshtjen e përgjatë. Dukshëm së jashtmi, si në pasarelata e modës ku nammerr luku... modeli, fustani, rroba... ku, si për shtyllën bosht të mullarit, s'pyetet hiç për ç'e mban, kush e ç'ia cyt dukjen e bukurisë... Si në përballje me fotoaparatin, ku, thujse lypet gjithçka tej anësore e tej synimit për të ditun se ç'është objekti. Ngjasoi gjithçka si në qenësinë e mendësisë ndërmjet kufomës së pavarrosun dhe pritjes të çelstit të cytjes për ç'meritonte: varr nderimi dhe monument lavdie...



2. Në foto: konsulli Italian: Alessandro de Rege di Donato. Foto P. Marubbi: 1881-1886 – Shkodër. Thënë: fotografia e parë shqiptare – (1856). Emërtuar gabim nga Kel Marubbi. Postë-kartolinë © në fotoarkivin Fusha.

Por, më parë se të vijojmë me ç'e përxix e shtyn të thënë gjithsesi, le të rrekemi për të thjeshtën e ndodhisë së gabuar. Le të rrekemi të qendrisim me fjalë ate çka mban fort të fiksuar hiposulfiti kimikat në kuadratin fillestar të fotografisë së hershme. Është negativ, në formatin 12x16cm., me emulsion kimikat të ngjeshun në suportin e xhamtë. Në Fototekën Marubbi, pozicionohet me nr. 239-*kler* (klerik). Brenda kuadratit me zgjatim së lartmi, figurohen dy njerëz, nën rroba ofiqi, të zeza, të dy meshkuj, më këmbë, pozicionuar të bindun nën udhëzimin kompozicional, zakonisht të fotografit, që kësohere po e marrim veçse kështu, pa hamendësi mëdyshjeje... Pra: kompozim i vetë fotografit. Qe ende shumë herët që fotografia të punohej me grupim apo stafe deri edhe me rregjizurë. Asokohe e përgjatë në ecuni të fotografisë, nuk mendohej për udhëzues mendor... por, veçse për ndihmës fizik. Ngase, paisjet fotografike peshonin, më së paku, 24 kg. 24 kg. minimumi peshonin edhe paisjet e lëvizshme. Për macahere themi, në kohën kur është fiksuar e jetësuar fotografia në gjykim. Jo vetëm kaq, fotografi qe vetzot në gjithçka edhe ngase, fotografia, disi ngjashëm e ndryshëm nga piktura, qe profesion që fitohej veçse i përzhytun përmes *shkollarizmit* të përvojës dhe pritjeve evoluive për perfeksionim. Qenë vitet 1860, kur fotografët patën braktisun *Dagereotipin*... nisën të braktisin edhe *Kalotipin* e Talbot dhe përqafën procesin *Colodium*, shpikur nga skulptori anglez Frederik Skot Arshe. Ngase, *colodium*, si në çdo histori ecunish, qe një avancë... qe një përzierje nitroceluloze dhe eteri që ngjiste e thithte kriprat e argjendit në suportin e xhamtë. *Kolodio* duhet të jetë edhe negativ që mbërtheu figurimin e Leonardo de Martino-s. Që qëndron në këmbë, i "goditun" brinjas e me portretprofil, nja 30 deri 40

vjeçar – po themi mendjengutun, me qyllat të zi mbi flokë, me mustaqe të zeza dhe gojën nën to që nuk ngjason e hapun. Dmth që nuk flet. Ndryshe nga dora e majtë goxha folëse...

Sidosesi...

... u cungua edhe Leonardo de Martino. U copëzua. U duk paksa e u fsheh disi mbi përgjysëm... Përse?! Qe prift... qe armik... qe me armiq... qe i keq...?! Apo qe i mirë aqsa... vetëm një *copëz* duhej t'i dukej... Hajde gjeje sesi... përse?! Kushedi?! asohere u pa e udhës të gjysmohej e veçohej aqsa: jo të shuhej fare!? Në foton e plotë të botuar këtu, na ndesh ta kufizonim katrorin tamam siç është prerja që prezanton Leonardon albumi: "Gjurmë të Historisë Kombëtare në Fototekën e Shkodrës" (1982). Shqiptarët e ardhmë, përherë në pakuptim, paprerë do të pyesin: Përse...?!

Ja pra sesi: asokohe (pjesa e dytë e viteve 1850) u sajua pjedestali si pakujdesshëm dhe rrena, mbeti përgjatë pashkulshëm: - trimi nammadh Hamz Kazazi dhe një përgjysëm italo-shqiptar: Leonardo de Martino... u ulën në qoshen ku nuk u përkiste... U blinduan të stisun a shtirun në kullën e fotografisë. Fotografia, kokëulun, i mbajti në mbrotje, si e bindun e besës... gjithsesi. U sajua edhe çelisi që kyçte me heshtje hovin e shpjegimit për më tutje... Dhe kështu, të dy, shkodrani rebel dhe gjysëmitaliani prift, medemek, jo i ngjashëm si ç'i kishim... u themelosën më 1856 dhe 1859... Dy vjetorë rreptësisht të fiksuara... Krejt pa ngjasi e krahasim me çdo punë fotografike pasardhëse, thënë me autorësi të Pietros... U themelosën edhe si për *hatër*, disi si një *nderim përmbyllës*, sido e diku... në kullën pa muze të fotografisë shqiptare... Leonardo de Martino u duk vonë. U ripoll sido i cunguar, më 1982. Në 70 vjetorin e Pavarësisë. Në albumin: "Gjurmë të Historisë Kombëtare në

Fototekën e Shkodrës". Në faqen 15. Në kohën kulm të kontrollit të botimeve. Edhepse, asohere, albumi u sajua me asi porosish që diktonin rreptësi cungune... gjithsesi, vlen ta pyes për gatitësin Kahreman Ulqini - që s'di nëse ende merr frymë mes shkodraneve të mirë - : Përse i veçuar dhe i gjysmuar kështu Leonardo, burrë vlerash...?! Përse i cunguar?! Përse i veçuar në kuadrat pa Prengë Bibë Dodën?!... Përse me cene edhe Leonardo, siç edhe i emëruari gabim Hamz Kazazi...?! Përse me gjasma dhe kohësuar... (!?) Përse duhej truku dhe gënjeshtria edhe për Leonardo de Martino-n tonë të mirë!?!..

\* \* \*

Nën rroba ofiqi të zeza figurohet edhe njeriu apo gjallesa e dytë. Me çka veshun, duket nga rrjedh: nga familje fisni që radhohen parësore. Mban dorën e djathtë të varun në çliri, përthyer dhe gishtgrecun në mesoren që i mbërthen belin dhe shpatën – shpatë mbase privërteti – varun majëposhtë edhe me dorën e majtë. Mbërthyer fort në dasi të tehut dhe trungut. Mbi supin suprinë të kësaj dore të djaloshit, hapërdahet gishtaçlirë pëllëmba e djathtë e burrit pranë (apo gjallesës tjetër), që, me gishtin e tendosun të dorës sallake, siç tham, vijon të përplasë në asgjekundi narrativin e fabulës që lutet papro të jetësohet dhe përligjet pa fallsitet, përtej e tëhu gojëmbylljes...

Se... Gojëmbyllun duket. Gojëmbyllun burri, edhe djaloshi. Veçse, *burri i vogël*, sikur flet shumë edhe ashtu, gojëmbyllun. Është vendosun gjetshëm aty, në bosht e mesore të hapësirës kuadrative. Dhe, djaloshi bukurosh, aktron parësor mbi gjithçka për rreth. Me fytyrë tipareplotë e simpatike. Pozicionuar gjysëmprofil. I bindun edhe ky në çka e kanë udhëzuar. Me vështrimin e përplasun në anësinë e majtë të fotoapararit. Vështrim që përplasat në asgjekundi, gjithsesi, disi i përligjun, ngase, duket se kurdis shqisën e dëgjimit të rrokë ç'farë thuhet... Ku, e tham, ashtu gojëkycun, zëshëm nuk thuhet asgjë... E, djaloshi i mençun, gjithsesi, di ta shosisë asgjënë... Aktoresk i përkryer!...

... për nga pamjaja...

*burri i vogël*... duket se janë përzier vllaznueshëm bukuria dhe zgjuarsia. Përherë, gjunjëzuar në start, me nervacytun... të gatshme për në ecuni... Për të rrokun sfida dhe histori...

... për nga veshja...

*burri i vogël*... dallueshëm: qysh herët rang fisni... Me *terzi* përzgjedhun, me siguri: radhuar në lista shërbjesish mbretorë. Madje, sharmi tejmoshe, vetishëm sikur thotë se, edhe mësuasi pranë, nuk mund të jetë kushdo... veçse, së pari, ndonjë burrë i zgjedhun kujdesshëm prej rrace mençunie...

... për nga mosha...

*burri i vogël*... nuk mund të jetë më i madh se 15 vjeç. As më i vogël se 13. Në një testim masiv, përrreth e mbi 13 vjeç është thënë. Antropologu shkencor Aleksandër Dhimo, aty, ca mbi 13 vjeç thotë. Edhe Ju, sapo ta shihni, nuk besoj se do të gjykoni ndryshe, veçse, rrotull e brenda asaj çka është thënë. Unë nuk desha të ndërhy, mbase për respekt të atyne që folën, por jam i detyruar të mos hesht, kuptohet: për ecuninë dhe fundin këtu, dhe, po caktoj minimumin e moshës së thënë, pra: ...13 vjeç. Ngase, shkencërisht, po respektoj FESH-in (*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*). Në FESH-in ribotim thuhet se ka lindur më 1859. Në FESH-in e parë (1985), shënohet se ka lindur më 1860. Kurse, në një botim goxha serioz historie që s'po di hë për hë në është botim i Akademisë së Shkencave, si dy FESH-at që cituam, *burri i vogël* e vitnis jetën më 1858. *Burri i vogël* u bë i madh dhe hyni në faqe Enciklopedie

dhe Historie ku, botimet top të gjitha, e vdesin më 1919. E lindin më 1858, më 1859, më 1860... – as më para dhe as më mbrapa – dhe e vdesin më 1919. *Burri i vogël* këtu, që u bë i madh, quhet pra Preng Bibë Doda. Edhe nga burime të tjera fotografike bindemi se *burri djalosh* – ngjitur me L.D. Martino-n, i fiksuar në xhamin e negativit *kolodio*, me nr. 239 dhe format 12x16 të Fototekës Marubbi, – është djaloshi P. B. Doda. Fotografi krahasuese nuk jemi rrekun të gjejmë për burrin pranë, ate me portretin profil dhe gishtin tregues të tendosun deri në lodhje, burrin e përzhytun nën rrobën priftërore dhe në rolin e urtisë menddhënëse... Për shumë bindje, qoftë edhe anësore, burrin fotografik, e kemi marrë të mirëqenë. Fotografia këtu përshtrydh e plotplotson thujtë çdo hap ecunie të Leonardo-s, pa shumë hapërndarje të fton sigurinë për bindje identifikuese. Mbase edhe ngaqë, shumë burime shkresore, gjithsesi, përputhen dhe, vetiu ftojnë intuitën t'ia përcaktojë pa mëdyshje personifikimin... Nuk jemi rrekun këtu për foto krahasuese edhe ngase, sikur, doja kësorasti *kohën* më parë se *kohën*... Dmth *kohën* se kur u shkreh fotoaparati... Dhe, gjithsesi, *kohën*, e ndamë mendjen ta quajmë edhe këtu, ashtu siç është thënë e thuhet: Leonardo de Martino. Po. Shumë hamendësi e rrethana që s'e tutin e trembin intuitën, thonë: po... Ky është pra Leonardo de Martino. Prifti poet. Poeti më i vlershëm, mësues përtej krishtërizmit për Preng B. Dodën... për At Gjergj Fishtën... për rregullsitë metrike të poezisë gegërishte që gatuan deri edhe shpirtin e Migjenit të vonë...

Kështu! Veçse, shqiptarët e shumtë, nuk e njohin Leonardo de Martino-n për çka tham. Nuk ia njohin goxha vlara të tjera jetësore. L. de Martino vjen e shket dukshëm ndonjëherë, vjen e shket dukshëm, veçse nëpërmendjeve kur flitet a shkruhet për fillesën e fotografisë shqiptare. Leonardo-n e mençun do ta habiste vakia kështu po qe se do ta dinte pasaktësinë. Neve tani zor se na habit. Jemi mësuar të ngatrorjmë gjokse dhe të qepim medalje e merita atje ku nuk duhet. Dhe, me një *shtytutje*: *E mò mirë!*... ndodh edhe të mos i lëvizim... Apo të mos i ndreqim, edhe mbas pafundësisë me debate shterpë dhe inate zhurmante. Sidosesi, Leonardo de Martino qe me vlara... Qe meshtar? Qe edhe tej meshtarisë... Qe mësues... Mësues!... Mësues morali e arti... Se qe i mençun?!... Sepse qe poet?... I lindun poet. Madje ndër më të mirët e asaj kohe. Poet niveli, me shpirt ndjesor... Me shpirt që thirri e lëmoi shpirtin njerëzor... Dhe, thuhet zëshëm nga çmues të mençun: mirësia vlerëmadhe që solli e mbolli Leonardo... E thotë edhe Koliqi, shkodrani me vlara. Që nga përtej Adriatikut ku qe përzënë me trup e nam, Ernest Koliqi, shkroi: "**Saggi di letteratura albanese**" (1972), ku: ... *kumbarët e vërtetë të epokës së re të letrave shkodrane qenë Leonardo de Martino dhe Atë Xanoni. Sidomos i pari, dha një provë të mundësive poetike të shqipes me shembullin e vargjeve të tij, të kalitura mirë, herë me shprehje të kulluar popullore, herë me ton të ngritur klasik, modeluar mbi shembujt e shumëllojshëm të metrikës italiane. Vepra e këtij poeti italo-arbëresh që shkroi në një gegërishte të përsosun, nuk është vlerësuar ende në masën e duhur. .... Tentativa e sukseshme e De Martino-s në përdorimin e gjuhës shqipe te krijimet letrare me frymëzim dhe lëvizje elegante klasike, i dha shkas mësimdhënies...*

Dhe, vërtetë, vlerat e veçanta të mendësisë dhe ndjesisë, Leonardo De M. ia dha urtësisë mësimdhënëse... Të thjeshtë e fantazisë diti ta hullio në frymëzimin e lirshëm dhe, Leonardo, e ngriti elegante poezinë deri në vlerat fine të metrikës së



3. Leonardo de Martino – Preng Bibë Doda. Thënë: foto: Pjetër Marubbi – 1859. Thënë: fotografia e dytë shqiptare... Në të vërtetë, jo!... Është fotografi e viteve 1870. Nga kjo plotësi është shkëputur portreti i L. de Martinos dhe ekspozuar me bujë si fillesë nr. 2 e fotografisë shqiptare më 1859: Përsëri: në të vërtetë – Jo!

përsosun... Solli edhe *metrikën jambike* dhe *Safon gegënishte*... Dhe, kur qe i namshëm kështu, botoi në Venedik (1881) "**L'Arpa di un italo-albanese**" (*Harpa e një italo-arbëreshi*), nja mbi 440 faqe poezi, në shqip dhe italisht. Botoi më të përzgjedhurën apo sentencën e vlershme të artit të tij poetik. Dhe mbeti mësuesi *primo* i Gjergj Fishtës, Ndre Mjedës, Pashko Vasës... Qe dhe mbeti mësues edhe i Preng B. Dodës, atij djaloshit syxixë që vijuan t'i xixnin përjetësisht rrezues edhe në foton që shohim. Dhe, fat (!) shyyr që sosi fotografia, t'ia përjetësonte ate xixim... Se, ia nxorrën njërin sy osmanllitë, më pastaj kur qe në internim, mbase, për ta zhbërë si vështrimqitës dhe ushtarak i zoti... Se, u shtoi telashe *osmanëve* si udhëheqës ushtarak i Shkodrës për *Lëvizjen Shqiptare të Prizrenit*... Se, Leonardo, e bëri më trim, ia shtoi atdhetarinë... Leonardo nuk qe për djaloshin mësues poezie. Qe mësues etike dhe mençunie... Se, nuk qe poetik djaloshi. Qe patriotik. Kishte ardhun në jetë për detyra tjerash. Qe nga derë pushke. Derë ofiqi, derë nga Kulla e Markagjonëve të Mirditës. Qe nga *Kullë pari*, me frëngji në sy shënjestrash... dhe ëndrra tej e më tutje... në hapësinë lirie.

\* \* \*

Ndërtimi fotografik që strehon e mbron Leonardo de Martino-n ka vlara. Ka mangësi dhe vlara. Mangësitë numërohen shumë më pak nga ç'renditen vlerat... Në kupë të punës mangësitë sajohen nga varfëria rrethore... Vlerat: asohere, kur truri di ta vjelë ndjesinë e shpirtit... Mangësitë i pjell ngutja, ndjesia

gjellë të mbara... por, herë e diku, shtohet lodhës dëshimi dhe vinte papritun dështimi. Ndodhte që rrugëve pa rrëfytes, hasej shpesh në zhgënjim dhe pakrye... Kështu edhe *xhelatina e bromurit të argjendit* – evoluive deri në një revolucion të papamë në praktikat fotografike... – u sajua për nja dhjetë vjet (deri më 1880) nga katër duar dhe dy mendje larg e veç, dhe eci përsëri avash edhe nëpër ca vite, duke kapërcyer shtigje bote deri sa sosi në Shkodrën shqiptare... Avash-avash edhe dekada e fundit e shek. XIX, nisi të shpaloste ditë e vite, me nën sqetull plot plane njerëzish, qendrisun me ca ëndrra shpresash në flu të gjithësishtme...

\* \* \*

Leonardo de Martino (1830-1923), pat lindun në Greçi të Kampanjës, në Krahinën e Avelinos. Qe arbëresh, madje, pjellë e pastër arbëreshe – thënë kështu – ngase, qe ende me taban të ruajtun, me mendësi shqiptare, me tradita e gjuhë të gjyshërve... Është thënë diku se qe rrjedhë e të ikurve nga veriu shqiptar, më 1467. Por, pa siguri kështu, aq më shumë kur në vitet 1400 (1432, '43, '48, '61, '67...), dyndjet shqiptare, përzënë përtej Adriatikut, u bënë ndodhi shekullore... Gjithsesi, Leonardo de Martino erdhi prift këtu, misionar i fesë. Erdhi më 1865. Që erdhi këtu më 1865, ve pikë shkencërisht dhe përbetohet besueshëm edhe prof. Vehbi Bala. Pra, vëre, misionari L. de Martino, shkeli së pari në truallin shkodran më 1865. E vërtetë shkencore kjo që jetëson argumentin fundësor se, fotografia e vitit 1859, mbetet sajësë... Po themi besueshëm edhe për ne, këtu, se... (ç'rëndësi ka...!), çka deshëm e kapëm... Ia spostuam pra, dhe gati ia saktësuam vilindjen fotografisë së Leonardo-s... E çvidosëm nga vidosja gabim, më 1859. E shtymë në kohë, atje, ku është e vërteta, nja dhjetë vjet e ca më mbrapa, mbas 1870. Së paku, mbi 1870. Kurrresi jo më herët...

Në vitin 1467 apo '68 – më me siguri kjo – një tjetër familje e madhe shqiptare, gati fisni, iku edhe ajo përtej Adriatikut. Bënë si bënë dhe u ngulën në Ribera të Sicilisë. Aty u shumuan në jo pak breza dhe asgjë nuk përzunë nga tradita *amë*... as nuk përqaftën përngutun traditën ku vajtën. Veç ajri dhe grosha qenë përherë pashmangie edhe në hapësinën italiane. Kështu mbase edhe sot, por për të mbetun të sinqertë me Ju, nuk di nëse nga trojet shqiptare, familja apo fisnia e namshme, iku dikur me mbiemrin *Krispi*... apo, ky mbiemër, u sajua në ecuni, siç edhe ka ndodhun gjetiu në aq kohëgjatë... Gjithsesi, fisnia apo ecunia ciklike *Krispi*... në nja ca breza deri në 350 vjet mbas largimit përtej truallit amtar... dhe nja 190 vjet të shtyra që nga sot, më 1819, saktësisht me 04.10.1819, cikloi mbi tokë pjellën më të namshme të autogenit... buçkon, me emrin Françesko. Françesko Krispi. Shpirtin e porositun enkas që nga mirësia... Që u rrit në fshatin Pallazzo Adriano. Dhe u bë avokat. Madje, edhe më tej. U bë vizionar... Vizionar praktik. Me ide që parashihnin të ardhmen. Me kontribut që i vlerësohet në tempujt e Kolosëve të Italisë. Qe mendësia vetë në treshen me përanash Xhuzeppe Maxini dhe Xhuzeppe Garibaldi. Qe ndër më të mëdhejtë dhe më të fortët për Bashkimin e Italisë së Lirë... Qe dy herë, nga katër vjet, Kryeministër i Italisë së madhe. Ngjau kështu pak para përmbylljes së jetës, në dekadën e fundit të shek. XIX-të. Vdiq në Napoli, në të hënën e datës 12.08.1901. Dhe u varros në Palermo, në kishën Santa Domenico. Qe veçanti e madhështi ajo ceremoni varrimi. U grupuan mbarë sicilianët. Erdhën edhe shqiptarët, nga anekënd Italisë. Sepse, arbëreshi Françesko Krispi e meritonte. Sepse...



(edhe sepse...) Onn D'Arco në tempullin e Parlamentit italian, i pat thënë: *Crispi, tu sei un "grands" per L'Italia!...* (Krispi, ti je shumë i madh për Italinë...). Ashtu sikundër, Pashko Vasa – burri që e njohti çdo shqiptar edhe i vogël, ka mëse një shekull, sepse tha: *"Feja e shqiptarit asht shqiptaria..."* – pat thënë edhe për Krispin: *"Françesku asht ma shqiptar sesa unë..."* Por, askush gjermësot nuk e dinte ç'tha macahere Pashko Vasa për Françesko Krispin... Françesko Krispi nuk u përzgjedh as për në FESH (*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*), - 1985. U injorua edhe ai si Nënë Tereza, fituese e çmimit "Nobel", 1979 – si edhe fotografi i namshëm botëror, korçari Gjon Mili... Të tre nuk u futën në Enciklopedinë Shqiptare – 1985. Tre nga ata që dëshira m'i nguli dhe fiksoi... Se, pati edhe të tjerë që botimi i injoroi. Pati plot. Jo tre, por goxha, nja tridhjetë, madje edhe mbi treqind... Dhe, justifikimi qe shkurt: nuk është shkruar për ta në shtypin dhe letrat e mbasLuftës... Ose, akoma më shkurt: ... *qe armik i popullit...*

E ringjallëm sido Françesko Krispin këtu, jo pa shkas. Ngase, përnxiti e shtyu për në Shqipëri Leonardo de Martino-n. Kushedi...(?!). S'do të vinte po të mos ngulte edhe Françesko Krispi. E them disi nga xhepi këtë, ngase, përveç fjalëve *miqësi entuziaste dhe andërrtare...* nuk gjejmë tjetër kyç për të zhbriur bisedën, që u bë në javën e parë të muajit të fundit – 1864. Krispi, qe bërë deputet i Parlamentit të Italisë së Bashkuar, në zgjedhjet e 15 Nëntorit, dhe, sapo pat nisun legal dhe shtruar edhe jetën politike. Qe shtruar ndryshe tashmë, dhe, një përzgjedhje të dëshirave ëndërrtare që ia diktonte gjaku i të parëve... ia porositi Leonardo-s. Dhe, u rehatua. Se u bind që kishte gjetun pahilen... Krispi e shtoi maninë. Për një si borxhë e si shpërblësë sado, për shërbesën trimërore që bënë shqiptarët arbëresh për Bashkimin e Italisë. Kontributi i të cilëve qe vërtetë madhor. Madhor dhe i namshëm. Ashtusi beteja dy ditore e arbëreshëve në lumin Voltorno, ngjalli heroizëm dhe përnxiti "Të njëmijtët" e Garibaldi-t që të shtoheshin në marshimin drejtë Napolit. Aqsa, Xhuzepe Garibaldi, mes qindra e mijëra arbëreshëve, u drejtua plot admirim udhëheqësit të tyre Dilush Damësi: *"Dames, questi tuoi arbereshet sono leoni!... (Damës, këta arbëreshët e tu janë luanë!...)"*

\* \* \*

Dhe ja ç'i tha Francesko Krispi - Leonardos në takimin plot ditëdiell, në pragmbylljen e vjetit 1864:

... *Shko! Në vendin e andrrave tona dhe të tanë arbëreshëve - Shko!... Boje mirësinë ene hudhe midet... Më parë se mbarë njerëzimi e kemi thanë ne shqiptarët këte. E kemi thënë përherë dhe thuhet marifetshe edhe si për të mos u nëpërmendun hiç shpërblimi. Dhe, kur thuhet e kryhet me shpirt, vjen vërtetë mirësia, vjen si shpërblësë e rehati borxhliu... ndonëse askush nuk e di se ku e se kur do të mbijë ajo mirësi... Madje, as ai dikushi që e mbollti farën dikur, në më të shumtën, hiç s'e di... Sepse... asoherë, edhe mund të mos jetë... e iku përgjithmonë pa e ditun... Mirësia shumohet varg në ecuni e njeriu i ardhmë dystohet ta vjelë pa hiç vramendje për ç'ia sollu... Dhe, ndodh të harrohet në ku s'duhet njeriu i mirësisë... Hiçmirë kështu, vjen mënjana dhe përzehet mirënjohja... Gjithsesi, ani... në s'ta lyp ate mirënjohje bamirësi i dikurshëm, ani!... Nëpërmendun Ti, për herën e veprës tënde!... Bëje Ti mirësinë dhe hudhe në det... Ngase, gjithsesi, koha e ardhmë ka përherë nevojë për ecuninë e mirësisë...*

# FOTOGRAFIA OSE DITARI I KOHËVE MODERNE

Nga Ina Kosturi



Arti më popullor mbështetur nga teknologjia Mund ta quajmë të tillë, ditar të kohëve moderne fotografinë që sot është kthyer në domosdoshmëri, pasion, ekzistencë, përditshmëri. Asnjë ditar i kohëve të shkuara, të vjetra, aty ku letërsia anonime qëndiste çdo ngjarje, episod, ditë, mendim, ndjenjë, detaj, nuk mund të ish aq i plotë sa panorama e sotme e fotove të individit për të fiksuar e publikuar gjithçka, duke u bërë personazh, e shpesh për të shpalosur botën përreth. Fotografia sot, në një term të gjerë, në kohën e zhvillimit të pandalor të teknologjisë ngjan se ka zbritur nga piedestali i artit, është shndërruar në pasion popullor, gjithëpërfshirës e të kudondodhur. Fotografinë amatore mund ta quajmë ndryshe dhe thashethemnjë të imazhit. Të tilla dukuri janë shfaqur dhe më parë në fusha të tjera të artit, sidomos në vende tranzicionesh si ky i yni, pas mbylljeve të gjata e varfërive si stinë dekadash, ndalesash të artit nga politika diktature. Vetë panorama e letërsisë ka dëshmuar për të tilla dukuri, shfaqur me maninë e botimeve nga individë shpesh larg letërsisë, hera herës si një modë e diktuar, e kthyer në një pasion popullor, duke krijuar imazhe të suksesshme individësh të vetshpallur, të cilët nga lexues kthehen në "shkrimtarë". Kjo kategori shkruesh për lavdi, nëse do i quanim kështu, kontribuese që pjesës së botimeve ti arrhohej kjo krijimtari pa sens e vlerë, e shndërron letërsinë në një lloj pasurie personale" intelektuale", që hipotekohej me histori familjare, trimërie, të të gjitha llojeve, një lloj letërsisë amatore, në thelb pa lidhje me letërsisë. Poezia vuajti po njësoj dyndjen gati barbare të individit për t'u marrë me të, duke krijuar për lexuesit një klimë zhgënjimesh pas çdo leximi të thjeshtë. Poetët mbinë si kioskat në faqe të shkruara e më shumë në ato online, si një shfaqje tjetër talenti artistik, për të cilin shqiptarët kanë ndjeshmëri të veçantë.

Pas letërsisë ky pasion përfshiu të kënduarit, edhe kjo dukuri e shfaqur si një tjetër "fushatë artistike" sa e pakuptimtë, aq dhe qesharake. E këtu shkëlqyen, u shpalosën, rezistuan më shumë se kudo modelet e këngëtarëve pa zë, debutues që zërin, talentin, famën, ua skaliti teknologjia, që stonaturat ua lëmoi kompiuteri, që i joshi fitimi, bashkë me tekstet jashtë serie, që u përshtatën me shijet e një pjesë të botës shqiptare e ju bashkëngjitën me forcë artit, duke krijuar atë që sot e quajmë tallavanë e këngës, apo degradimin e saj të madh, një situatë sa të rëndë aq dhe të pandreqshme. Nëse në letërsi fushata e talenteve fallco gradualisht filloi të njohë paska rënie, apo me kalimin e viteve ky pasion për krijime erdhi duke u sfumuar, muzika tallava u instalua në lokale, ngado, si një zhurmë me të cilën një pjesë e konsiderueshme e popullsisë shqiptare gati u mësua. Komentet nën zë, konstatimet nga studioli televizive nuk mundën ta zbehin as zvogëlojnë këtë qasje që mediokriteti lançoi në muzikën e lehtë, që u ngit lart e më lart deri në festivale, pa mundësi riparimi, pa shanse stopitjeje, në një masivitet të frikshëm me të cilin shqiptarët thuajse janë ambjentuar.

Zhvillimi pa limit i teknologjisë duket se e zhvendosi vëmendjen nga këto pasione që gjithsesi kërkonin impenjim. Bashkë me pasurimin e shpejtë e të pandalshëm të modeleve të celularëve, sofistikimin e kamerave, përdorimin e filtrave, programeve, pasioni për fotografinë u rendit në majën e rradhës së pasioneve. E ky nuk është një fenomen vetëm shqiptar! Ndryshe nga letërsia, nga kënga, masivizimi i fotografisë erdhi më natyrshëm, pa sforcë, paralel bashkë me sofistikimin e celularit, gati pa kosto, pa rregulla. Kjo lloj fotografie nuk kërkoi as talent të sforcuar si në letërsi, as zë të përpunuar si në këngë, as tekste, as studio incizimi, as skenë, as përkrahje. Kjo fotografi amatore kish qaq pak kosto, qaq pak mund, dhe qaq shumë truke të thjeshta, pasion e mundësi të pafundme për të guxuar me të. Ajo erdhi si dhuartë e përparimit të teknologjisë, kohës moderne. Ajo ngjason me debutimet në karaoket e këngëve, ku mfajon të rrëmbesh mikrofonin, madje më thjesht, pa lëvizur, pa zhurmë, pa tinguj,

në privatësi. Ajo duket se i rrëmben individit kohë nga koha e leximit, i merr kohën e dëgjimit të muzikës, e shndërron befaz në një artist të pavarur i cili ska nevojë për askënd. Opsionet e celularit, filtrat, truket, janë më të thjeshta e me to mund ta ndryshosh realitetin a pamjen, të krijosh imazhe të reja, sa fallco aq dhe të kuruara, si në asnjë formë tjetër të artit. Dhe kështu lindi dhe tallavaja e imazhit, shpalosur me fytyra të kuruara, imazhe të ndryshura. Tallavaja e imazhit ndryshe nga gjinitë e tjera u publikua në rrjetet sociale masivisht, duke filluar me imazhin e individit që u ndryshua aq shumë ndonjëherë, sa midis personazhit real dhe atij të publikuar ka fare pak ngjashmëri. E në këtë tallava imazhesh i pari ndryshoi portreti femëror, i kuruar në maksimum, ndërsa portretet reale ishin shëmbëlltyra përtej publikimit. Efekti i dritës, filtrat, opsionet zgjatura e herë holluese ndryshuan trupa femërorë, në vartësi dhe të një mode e cila pushtoi pikërisht imazhin e njeriut. Nuk ka nevojë të shkruash, të këndosh, talenti më në modë është pozimi, ose imazhi i kuruar në rrjetet sociale. Këto rrjete nuk shpallin as datë e as konkurrin, po përtej kësaj lirie në mendjet e individëve u shtua pasioni për imazhe, më te njëjtën devotshmëri si ndjekja e telenovelave! Përtej figurave femërore që ngjajnë njësoj me këngët tallava apo poezinë mjerane të rrjeteve sociale, ky pasion është i përbotshëm, përtej shqiptarëve, pasion real i kohës moderne.

Krahas tallavasë së imazhit apo një lloj ndjesie se fotografia po shndërrohet në një art mëse popullor, ngjashmërisht me ndikimin e kompjuterit në zë e këngë, duket se edhe pse amatore ajo ndryshe nga artet e tjera, apo tallavatë e tjera, ruan, dëshmon një tjetër specifikë. Ajo mbron misionin elitare edhe pse amatore kur bëhet dokumentuese e natyrës, bukurive të rralla, kur ky pasion fikson përdime dielli e peizazhe mbresëlënëse, natyrën e mrekullueshme e shndërrohet në promovuese dhe njohëse të së bukurës. Kjo specifikë të cilën individi amator e shpalos nëpërmjet fotove i jep vlerë edhe pse tashme si shfaqje e ardhur nga përparimi pa limit i teknologjisë edhe pse tejet e limituar. Ndryshe nga letërsia e kënga ajo inkuadrohet në festivale amatorësh, të destinuar të tillë. Fotografia ka qënë gjithmonë e rëndësishme, e jashtëzakonshme në pasqyrimin e ngjarjeve historike, luftrave, evenimenteve politike e kulturore, shkencore, dëshmirare e të shkuarës së largët, dokumentuese portretesh të personaliteteve botërore, dëshmitare e gjithë universit, natyrës, botës së gjallë, të bukurive, midis gëzimit dhe tronditjes në një mision tejet të rëndësishëm e të pafund. E megjithatë asnjëherë nuk ka qënë kaq e thjeshtë, e prekshme nga një masë njerëzish larg artit, profesionalizmit, në një mani shkrepjesh, fiksimit momentesh, peizazhesh. Fotografia është art dhe njëkohësisht pjesë e arteve me të cilat bashkëvepron duke i frymëzuar, dokumentuar, plotësuar, duke i dhënë imazhin drejt fjalës, tingullit. Ajo është kopertinë e lajmit, kopertinë e librit, dokument i individit, kopertinë e natyrës. Ndërsa individi nëpërmjet saj në kohët moderne të teknologjisë përpiket, kamufllohet, frymëzohet për tu shfaqur paksa artist. E kështu fillon të krijojë ekspozitat e tij modeste marrë nga galeria e pafundme e të madhes natyrë. Individu modern krijon "ekspozitat" e tij modeste me përdime dielli, tablo dimri të bardha në udhë të mbuluara dëbore, duke shfrytëzuar gjithë arsenalin e bukurive që natyra ofron si art i rrallë dhe i papaërsëristshëm. I rrëmben shpesh letërsisë fjalën e përshkrimin për t'ja servirur njerëzve thjesht nëpërmjet imazhit. Ajo ngjan herë me dublat e filmit, e herë me studimin e pasazheve muzikore në instrument, e si piktorët impresionistë ka çastin e shkrepjes si këmbanë sinjali të asaj që ndodh. Fotografia si pasion i kohëve moderne është këngë në tonalitete të ndryshme, e ëmbël kur pasyron të bukurën e promovon Shqipërinë, duke zgjuar tek individi pasione artistike e ndjesi të rralla, si një pasuri personale, pa marrë pjesë në festivale profesionistësh.

Më 14 gusht të këtij viti, u shua në Ankona të Italisë, Kristaq Dhamo, 'një artist me A të madhe', siç e vlerësoi atë prof. Përparim Kabo.

Kam patur fatin të punoj disa vite në Kinostudion 'Shqipëria e Re', një nga institucionet më të mëdha të filmit shqiptar. Ishte mesgushti i vitit 1983, kur kapërceva portën e madhe, pastaj kalova në të majtë, mes një hapësire të gjerë, të murit rrethues dhe godinës hijerëndë të stilit sovjetik. Më bëri përshtypje gjelbërimi dhe lulet e shumta në të dy anët, një shatërvan dhe porta tjetër e madhe e hapur, hollit i katit të parë, shkallët që të çonin në katin e dytë, koridori i ndriçuar zbehtë dhe dyert e mëdha të administratës, drejtorit, redaksive të filmit artistik e dokumentar. Në zyrën e kuadrin bëra veprimet rutinë dhe duke dalë, takova Fuat Çanon, i njohuri im i kahershëm, ekonomist në këtë institucion dhe njeri shumë i mirë. Pastaj Vath Koreshi, që më përqafoi dhe uroi. Ai më futi krahun dhe më ftoi të pinim diçka freskuese, në një lokal të vogël, brenda territorit të Kinostudios. Do jemi bashkë, tha Vathi, me të folurën e tij të butë, shoqëruar me buzëqeshjen karakteristike dhe mirësi. Shefi i redaksisë së skenarëve të filmit artistik është Abdurrahim Myftiu, që ti e njeh, kur ai ishte mësues në Kavajë, tha Vathi. Me ardhjen tëndë këtu bëheni tre nga ajo zonë, shtoi ai. Po, po, thashë. Ku është Nexhati Tafa, pyeta. Ndoshta vjen nesër, tha Vathi. Pastaj më pyeti se si po shkonte libri me tregime, që prej pesë vitesh e kisha çuar në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri". Unë heshta, ndërsa Vath Koreshi i mirë dhe dashamirës dhe një nga njerëzit e rrallë, që kam njohur, më tha që të mos mërzhitesha dhe më uroi edhe një herë për fillimin e punës në Kinostudio.

Kjo ishte dita e parë e punës time në Kinostudio. Në vitin 1983, ky institucion ishte në kulmin e prodhimit të filmave artistikë, dokumentarë dhe vizatimorë. Shqipëria e vogël kishte industrinë e filmit, që siç e citon prof. Përparim Kabo, të paharruarin Kristaq Dhamo: "Një shoqëri me industrinë filmi, është një shoqëri që mund të zhvillohet".

Kristaq Dhamo ishte kryetar i Këshillit Artistik dhe ishte fat, që këtë organizëm të rëndësishëm, ku diskutoheshin dhe miratoheshin skenarët e filmave, drejtohej prej një nga regjisorëve më të mirë, me kulturë të gjerë për filmin, historinë dhe gjuhën e tij. Jo vetëm kaq. Te Kristaq Dhamo si te askush tjetër ishin bashkë, në një harmoni të çuditëshme, artisti dhe njeriu me Nj të madhe. Që në takimin e parë me të (mbaj mend me poetin Ndoc Papeleka, që nisi punën në redaksinë e filmit artistik), më bëri përshtypje thjeshtësia dhe mirësia e Kristaqit. Ai u çua në këmbë dhe pasi na uroi për fillimin e punës në Kinostudio, u ul përballë nesh duke na pyetur për shëndetin, familjet tona dhe punën që na priste në këtë institucion. Ishte jo shumë i gjatë. Dukej natyrë flegmatike. Më bëri përshtypje vështrimi i butë i syve të tij dhe vështrimi i zgjuar dhe zhbirues i tyre. Kishte dhe njëfarë melankolie në atë vështrim. Dhe pa dyshim buzëqeshja e natyrshme që përshfaqej në tërë portretin e tij. Ky ishte Kristaq Dhamo. Dashamirës dhe tolerant. Asnjëherë nuk e ngrinte zërin. Ai kishte një të folur të ngadaltë si të pambuktë. Kristaq Dhamo dinte të bënte mirë dhe vetëm mirë, duke mos lënduar asnjë.

Në bisedat me regjisorin e dhjetëra filmave dokumentarë, tashmë të ndjerin Kujtim Gjonaj, me të cilin kam realizuar disa filma, mbaj mend që ai më thoshte, se Kristaq Dhamo si udhëheqës artistik, ishte një nga personalitetet më të respektuar të filmit shqiptar. Sa herë diskutoja me të për

## In memoriam

# PËR ARTISTIN DHE NJERIUN KRISTAQ DHAMO

Nga Enver Kushi



problemet e filmit, ndjeja një kënaqësi të veçantë, shtonte Kujtimi.

Këto ditë, në një nga dosjet e mia, krahas dy recensioneve, paraqitur në Këshillin Artistik, për skenarin e filmit artistik "Binarët", shkruar nga regjisorin i mirënjohur Kujtim Çashku dhe shkrimtari dhe skenaristi Roland Gjoza, gjeta shënime që kam mbajtur në mbledhjen e këtij këshilli. Janë vërejtjet dashamirëse të Kristaq Dhamos, për skenarin e shkruar nga unë dhe Muharrem Fejzo. Duket, që kryetari i Këshillit Artistik e kishte lexuar me shumë vëmendje skenarin, sepse vërejtjet janë të detajuara për çdo faqe dhe episode. Ato janë shumë konkrete dhe profesionale.

Filmi "Binarët" u shfaq për herë të parë, mos gaboj, në nëntor të vitit 1987. Ishte e zakonshme që këto premiera të jepeshin para kolektivit krijues. Mbaj mend, që ai u duartrokoi gjatë, duke u vlerësuar si një nga realizimet më të mira të regjisorit Muharrem Fejzo. Ditët që pasuan premierën dhe suksesin e merituar të "Binarëve" në Kinostudio, do



të ishin të zymta. Në Komitetin Qëndror, ku u pa filmi, erdhën breshëri vërejtjesh për nxirje të realitetit socialist, gabime të rënda ideore etj.etj.

Regjisorin Muharrem Fejzo, në librin "Të pathënat", botim i vitit 2015, shkruan, se bashkë me Enver Kushin, pasi kemi rrugëtuar në gjithë viset ku kalonte treni dhe stacionet e tij dhe kemi takuar dhe biseduar gjatë me ata që lidhnin popullin e republikës me hekurudhat, u shtruan të shkruajmë skenarin letrar. Më 12 mars 1986 i dorëzohet skenari letrar Abdurrahim Myftiu. Po në këtë libër Muharrem Fejzo, ka një shënim që mban datën 12 nëntor 1987: "Mbledhje me Kristaq Dhamon, kryetar i Këshillit Artistik. Kristaqi u tregua shumë i kujdesshëm, në përçimin e vërejtjeve, në adresë të filmit. Ai e dinte shumë mirë gjendjen timë emotive dhe historinë e sëmundjes së zemrës dhe tensionit...".

Kristaq Dhamo është mësuesi i shumë regjisorëve dhe skenaristëve të filmit artistik dhe dokumentar shqiptar. Ai njohuritë dhe përvojën e gjatë në fushën e filmit ua dha pa kursim kolegëve të tij më të rinj. Kristaq Dhamo ishte një enciklopedi e gjallë e filmit. Mbaj mend, që me nismën e tij, në shtator të vitit 1984, pranë Institutit të Lartë të Arteve u çel për herë të parë Kursi njëvjeçar për skenaristë dhe regjisorë të filmit artistik e dokumentar. Kam patur fatin që gjatë periudhës shtator-korrik të vitit 1984-85, të specializohem në profilin "skenarist", pranë këtij Instituti. Në programin njëvjeçar të këtij kursi, ideuar nga Kristaq Dhamo, përveç filozofisë, estetikës, kulturës së gjuhës, ishin edhe këto lëndë: teori e skenarit, reori e fimit dhe përbërësit e tij, skenari regjisorial, filmi vizatimor, filmi dokumentar, histori e kinematografisë botërore, histori e kinematografisë shqiptare. Kristaq Dhamo u kujdes që për të na dhënë leksione në lëndët e mësipërme, të ishin emrat më të njohur të regjisë dhe skenarit të filmit shqiptar, si Dhimitër Anagnosti, Gëzim Erebara, Vath Koreshi, Todi Bozo etj. etj.

Ai jo vetëm na jepte leksione për teorinë e filmit, por kujdesesh për ecurinë e përditëshme të këtij kursi. Jo vetëm kaq. Herë-herë, ne linim auditorët e Institutit të Lartë të Arteve dhe shkonim në një sallë të vogël në Kinostudio, ku shihnim filmat më të njohur te regjisorëve më të mëdhenj, rusë, italianë, francezë, anglezë, amerikanë, grekë etj. Këto filma ishin të ndaluar të shfaqeshin për publikun e gjerë. Profesori dhe regjisorin Kristaq Dhamo, merrte përsipër rreziqet e kohës, për të na "ushqyer" ne studentëve pasuniversitarë të këtij kursi, me arritjet e mëdha të kinematografisë botërore. Për këtë, jo vetëm unë, por edhe dhjetra skenaristë apo regjisorë, u jemi mirënjohës artistit dhe njeriut të madh Kristaq Dhamo.

Lamtumirë mjeshtër Kristaq Dhamo!

Lamtumirë kapedan i filmit shqiptar! Shpirti yt fluturon hapësirave të Libofshës dhe fushës së Myzeqesë dhe botës së trazuar shqiptare, historinë e së cilës e bëtë të pavdekshme, nëpërmjet imazheve filmike.

Ju ngjasoni, me atë që shkruan në shekullin e dhjetë, një poet i madh mistik i Lindjes:"

Unë s'kam vdekur, unë s'kam vdekur  
Për Zotin s'kam vdekur  
Jam i gjallë,  
Zogu që del e që ndrit,  
Trupin në kafaz e lë, e braktis.

**E PASHË NË ËNDËRR**

E pashë në ëndërr babain që ecte,  
ecja s'mund të fshihet si diçka kalimtare.  
I kthyer në dritëz, pikëz në mjegull,  
ishte babai që ecte,  
kjo ëndërr s'mund të jetë si të tjerat gënjeshtare.

E pashë në ëndërr babain që ecte,  
me trastë mjeshtroku në udhë gurë - dertesh,  
mbi kreshta të thikta përgjërë - pengjesh,  
mbi male të shenjtë ballkani ecte.

Ecte mbi supe resh, nëpër lotë shirash,  
ecte trishtueshëm, heshtur, tretur ecte.  
Ç'rëndësi kishte në frynte shtrëngatë,  
e binte dëborë përmbi dete.

E pashë në ëndërr babain që ecte,  
ecja s'mund të fshihet si diçka kalimtare ...

**BIÇIKLETËN NGËT SI NJË I VERBËR...**

Vrapo më mirë midis granatave, se sa të rrish gërmadhëve,  
Që bota mos shkojë drejt ferrit, fëmijë lufte në KIEV.  
Fatin e parashkruar mos e lidh me këtë drejt kyçi prej  
gjaku e mishi,  
Në shtëpinë mbushur me mina, ku hidhemi në erë.

Nuk fle dot, nuk fishkëllen dot, ka ulërimë avioni e pred-  
hash,  
Ti kërkon dritën, aromën e qumështit, aromën e pyllit.  
Dhembshuria zbret mbi tokë kur zoti ndjen mall për  
njeriun,  
Fatin e parashkruar mos e lidh me këtë drejt kyçi prej  
gjaku e mishi.

Ik, ik o ëngjëll i pafaj? I pajetë, në urën këputur përmbi  
lumë,  
Që biçikletën e atit të humbur, si një i verbër e nget.  
Fotografo pellgjet, cifelat e copëzat e trupave nëpër  
gropat,  
Ndërsa në treg ka vetëm qirinj varrezash për festë ...

Ik o ëngjëll i pafaj, që biçikletën e atit nget si një i verbër ...

**VETËM TI**

Vetëm ti ma ke rrëmbyer kujtesën.  
Ç'ti them erës që gërvisht me thonj në qelqe.  
A e kam humbur atë flakëzën e shpresës,  
Pyes gërmat e ujit që pemës së durimit varen ...

Vetëm ti ma ke rrëmbyer kujtesën.  
Sa grackat dhe ëndrrat pa ty i refuzoj.  
Gjethet e trishtuara ranë gjithë natën,  
shkrime shiu në erën e çmendur,  
që tani kushedi se ku bredhin?

Vetëm ti ma ke rrëmbyer kujtesën ...

**TI JE E VETËMJAFTUESHME ...**

Ç'të mbjell për ty në tokën pakufi të metaforës.  
Premtime shiu apo fjalë të kripura deti,  
pjekur në diellin e jugut përvëltonjës?

Je shpirt lumi i rrëmbyeshëm,  
damarëve të nëntokës,  
ujë kristal, e qeshur prilli,  
thellë, në brinjë të rrëkezës,  
përbrenda dëborës ...

Ç'të mbjell për ty në tokën pakufi të metaforës?  
Mbase një tufë dobësisht tokësore,  
të qortueshme.

Sepse ti je e vetëmjaftueshme ...!



**KOKËTUNDËSIT**

Kokëtundësit janë veç numra, nuk kanë emër,  
Ka humbur thelbi "unë", ndjesi e njëjtë gjithnjë.  
Të gjithë me preferenca barabar, pa zemër,  
Asgjë nuk është e tyrja, kanë vetëm hiçasgjë.

Me urdhër dashurojnë, riprodhohen me dekret,  
Kanë humbur fytyrën, nuk njohin mëshirë.  
Janë pronë e të gjithëve, pudrosen me shtet,  
E zeza më e errët e të zezës, uniform - zezim.

I njëjti dekor tek kokë e krevatit,  
Telajo e ngjyra njësoj, piktura skematike.  
Pa kujtesë. Fshirë emri i nënës dhe atit.  
Asgjë njerëzore, dhe shenjat e gjumit simetrike.

Kokëtundësit janë veç numra, nuk kanë emër,  
Ka humbur thelbi "unë", ndjesi e njëjtë gjithnjë.  
Të gjithë me preferenca barabar, pa zemër,  
Asgjë nuk është e tyrja, kanë vetëm hiçasgjë.

**ADRESA IME ...**

Adresa ime është e pandryshuar në shtëpinë  
ku banojnë "lisi i tamblit" dhe "lisi i gjakut",  
në një ballkanase, midis shfaqjes së ngrirë  
dhe thelbit të fshehur.  
Në portën me dorëz ilire  
a tmerr' i vjetër i përkatësisë etnike,  
në zjarret e rëna hambarëve të kujtesës.

Mos e harro!  
Adresa ime e pandryshuar në ngrehë të jetës,  
vrujon si përrua, trumbetë e çarturi e pafund që ngjan  
me hutimin e ujkut nga dritë e vetëtimës.  
Nuk humbin dot as qokat, as gjedhet e saj,  
prej supersonikut e qelqit digital,  
është e shkruar në lëkurën e njeriut.

Adresa ime s'është një keqkuptim që përsëritet,  
e largët, e paarritshme për udhëtarin,  
që se rrok dot këtë përmasë të padukshme lirie.  
Ajo është atje në Gjirokastrë,  
në kasafortën shekullore, në bërthamë të gurit,  
vena të holla gjaku, fije ... fije ...

**TI ZBRET SI LUMË ...**

Ti zbret si lumë në rëzë të malit,  
duke vaditur ditët e mia të vjedhura.  
Pret pas shkureve diçka të shkatërohet,  
për një sekondë fjalët të shndërrohen në tinguj.

Në vrullin që fsheh brenda vuajtjes,  
është turpërim i virgjër  
që ndahet padashur nga gjërat e vogla.  
Ti zbret si lumë në rëzë të malit,  
të humbasësh tek një shpresë e egër  
që të tjerët nuk e kanë.

Ti zbret si lumë në rëzë të malit,  
dhe i ngul sytë diellit që do lindë nesër.  
Ëndërron si një zog që mbi re fle pezull,  
Sepse unë e di që fsheh plot naze e hire,  
dhe nuk ke vendosur ende të bëhesh e rritur.

Ti zbret si një lumë në rëzë të malit ...

**VJOSA**

Të kesh gruan e egër brenda vetes.

Lumin Vjosa.  
Qetësinë e ngjyrës kuaz në verë,  
harbimin e papërfytyrueshëm në dimër.

Gjithë zotat i ke zbritur në tokë,  
imagjinatën sipër.

Ta kesh lumin e egër brenda vetes,  
Vjosë - një grua qumësht.  
Qetësinë e ngjyrës kuaz në verë,  
në dimër të papërfytyrueshmin harbim.

Tokën e ke të bekuar prej zotit,  
diellin të florinjte.

**POETËT**

*Kushtim Bardhyl Londos.*

Poetët ngajnë kaq shumë me njëri - tjetrin,  
ndonëse qenie në ikje, në rrallim.  
Kanë të njejtat fytyra dhe dëshirën  
të rikthehen në vend - shenjtëritë e fëmijërisë.

Poetët kanë të njëjtin zë të thellë, të lodhur,  
në kërkim të gjërave të vogla,  
fundit të zemrës humbur.  
Bëjnë të njëjtat gjeje, lëvizje me duar,  
dëshpërimin e botës ta shkërmoqin në pluhur.

Poetët se kanë dhimbjen fjalë të shpërdoruar,  
por tingull, gjëmim e gjak në venë.  
Poetët ngajnë veçanërisht tek sytë,  
tek drita që i shtyn çdo ditë në protestë.

Poetët ngajnë kur shtegëtojnë si pelegrinë.  
Poetët dinë të kacafyten egërsisht me qetësinë ...!

Letërsia është djepi që përkund e ledhaton të gjithë morinë e ndjesive dhe emocioneve tona si qenie njerëzore duke ngacmuar shqisat dhe imagjinatën e lexuesit e duke krijuar me të një marrëdhënie tepër intime. Herë burim kënaqësish e herë të tjera dertesh, ajo na shpie në vise ëndrrash e zgjëndrrash të cilat i shohim të derdhura në rrjeshta shkronjash e rrokjesh që i japin kumt ndjenjave dhe përjetimeve tona. Ajo është kënaqësi nga e cila një lexues nuk mundet e nuk duhet ta privojë veten. Por që një letërsi t'i kapërcejë kufijtë e vendit ku ka lindur, ajo lipset të përkthehet në gjuhë të tjera.

Shumë është folur e shkruar për filozofinë e përkthimit letrar. Ca e shohin si një sipërmarrje donkishoteske, paçka se fisnike, të tjerë si një domosdoshmëri, ca si punë e të tjerë si art më vete. Ne mendojmë se është një punë me vlerë që lips “art”, pra mjeshtëri, dhe se vlera e çdo pune nuk mund të jetë më e vogël se sa zelli dhe dashuria me të cilat një njeri e bën atë.

Krijimi i një marrëdhënie të mirëfilltë me lexuesin është nder apo meritë që i takon autorit të tekstit, por ruajtja e kësaj lidhjeje në përkthim është detyrë e përkthyesit, një mendje e trajnuar në njohjen e mekanizmave që lipset për të transportuar tekstin nga gjuha burimore në gjuhën e synuar. Megjithatë ky proces nuk është gjithnjë i lehtë dhe i pacen, sidomos kur përkthehet nga gjuha e origjinës në gjuhën e huaj.

### TË PËRKTHESH NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHËN ITALIANE

Kur mendojmë për përkthimin, kahu drejt të cilit përkthehet rëndom është nga gjuha e huaj në gjuhën tënde. Të paktën kështu e lips zakoni, mendimi kolektiv, praktika gjuhësore apo edhe vetë përkthyesi. Por ndodh edhe... ndodh edhe ndryshe.

Duke nisur nga përvoja personale, prej të cilës merr shkas edhe punimi ynë, po sjellim disa reflektime të bëra gjatë procesit të përkthimit nga shqipja në italisht të librave “*Otello, Arapi i Vlorës*”, i autorit Ben Blushi, fitues i Çmimit “*Europa Krijuese 2014*” dhe librit “*Vrasje në Kryeministri*”, i autores Diana Çuli, fitues i Çmimeve Kult si “*Libri artistik i vitit*” 2019.

Duke përdorur fjalët e John William-it<sup>1</sup>, në librin e tij *Stoner*, është “*dashuria për letërsinë, për ligjërmin, për misterin e mendjes dhe të zemrës të cilat shfaqen në atë gërshetimin e hollë, të çuditshëm e të paparashikueshëm që ndodh mes shkronjave dhe fjalëve*” që e nxisin dhe frymëzojnë përkthyesin gjatë punës së tij, gjatë procesit të përkthimit.

“*Deti nuk të jep kurrë mundësinë të MOS mendosh për bregun tjetër*”<sup>2</sup>, shprehet Kasio, një personazh i librit *Otello, Arapi i Vlorës*, ashtu siç edhe përkthyesi nuk mundet kurrë të MOS mendojë për përkthimin në gjuhën tjetër. Është një refleks i pakushtëzuar, i vetvetijshëm i cili ndikohet nga disa faktorë siç janë gjinia letrare, konteksti historik, vështirësitë gjuhësore, kahu i përkthimit (nga apo drejt gjuhës mëmë), stili i autorit, aftësitë dhe përvoja e përkthyesit, aspekti kulturor, social etj.

Le t'i kthehemi Otello dhe “brigjeve të tij të përkthimit”.

Libri rrëfen historinë e një udhëtimi mes dy brigjeve, i vendosur mes viteve 1300 dhe 1400 në dy qendra urbane të njohura të Mesjetës, në Venecia dhe në Vlorë. Vendet, ngjarjet dhe përshkrimi i personazheve janë një ndërthurje mes së vërtetës dhe legjendës, mes reales dhe fantazisë, mes së shkuarës dhe së tashmes, mes Shekspirit dhe Blushit. Një trillim letrar i lidhur ngushtë me faktet

1 Citim i marrë nga një foto tek “*Salloni i librit në Torino*”, 2018.

2 Ben Blushi “*Otello, Arapi i Vlorës*”, fq. 369, MAPO editions, Tiranë, 2011.

ExLibris - sponsor medial i konferencës shkencore ndërkombëtare, “**ÇËSHTJE TË GJUHËS, LETËRSISË DHE PËRKTHIMIT LETRAR**”.

Fakulteti i Filologjisë i Universitetit “Fehmi Agani”, Gjakovë

# PËRKTHIMI LETRAR: ARTI I TË PËRKTHYERIT TË EMOCIONEVE

Dr. Elda Katorri & Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali

Përkthimi letrar është padyshim niveli “më elitari” që një përkthyes mund të synojë. Por, si çdo disiplinë tjetër, ai ka ngjallur e vazhdon të ngjallë mjaft debate, diskutime e mëdyshje. Debatet më të shpeshta vërtiten rreth faktit nëse përkthimi do konsideruar si një e shkrepur aparati fotografik e cila arrin të përcjellë nga gjuha burimore në gjuhën e synuar po atë shije e ato ngjyime semantike, të ngjallë po ato emocione e të ruajë po atë stil të autorit.

Duke nisur nga përvoja personale, prej të cilës merr shkas edhe punimi ynë, mendojmë se akti i të përkthyerit është një proces përpunimi i vazhdueshëm i cili na ndihmon të kuptojmë ngjashmëritë dhe dallimet strukturore, diskursive dhe tekstuale që ekzistojnë mes dy gjuhëve. Ai është proces zgjedhjeje që kryhet duke peshuar mirë alternativat, mundësitë e zgjidhjet gjatë të cilit kompetenca gjuhësore dhe aspekti kulturor ndërthehen fort me njëri-tjetrin. Punimi mëton të trajtojë disa çështje praktike të procesit të përkthimit letrar nga gjuha shqipe në gjuhën italiane të kryer nga përkthyes shqiptarë.

historike, një ndërthurje fatësh e ndodhish që ciken, preken, përplasen e ndërthehen me njëra-tjetrën duke ndikuar në mënyrë të pashmangshme jetën e tjetrit.

Otello, ai i Vlorës, është emri që Desdemona, vajza më e vogël e Albano Contarinit, një pasanik dhe tregtar i Venedikut, i jep skllavit që i ati i blen në port, ku çdo ditë mbërrijnë anije të panumërta për të shitur mallra, të çdo lloji, përfshirë edhe burra dhe gra të ardhur nga shkretëtira ose nga vende të largëta. Ky pra, është një shkëmbim i vazhdueshëm, një luhajtje mes brigjeve jo vetëm historik, por njerëzish dhe jetësh të hedhura në mëshirën e një të ardhmeje të pasigurt që tanimë është në prag, do të shfaqet, për mirë ose për keq.

Bëhet fjalë për një periudhë në të cilën lulëzoi tregtia midis Venedikut dhe Vlorës, atë kohë nën sundimin e familjes Balsha, në një Shqipëri që ende nuk ishte e vetëdijshme për kanosjen e pushtimit nga turqit. Otello, Desdemona, Emilia, Iago, Kasio nga Venecia e Shekspirit, duket se janë transportuar nga Blushi si në një udhëtim që kthehet pas në kohë, duke mbërritur në Vlorë ku do të takojnë shumë figura të tjera interesante,

vendase dhe të huaja, si doktorin e njohur Stefano Gjika, të riun Andrea, pushtuesin turk Hamit, fisnikun pasanik Albano Contarini etj. Teksa e lexon librin, e gjen veten të magjepsur nga çdo rrjesht, i cili duket sikur të shpie në rrëfimet e “Një mijë e një netëve”, në pallate përrallore stolisur me gurë të çmuar e parfume erëmirë që të dehin shqisat.

Dhe transportimi i atmosferës së “Një mijë e një netëve” nga gjuha shqipe në atë italiane ishte sa një sfidë e vështirë aq edhe një përgjegjësi e madhe.

Vështirësia e parë që haset, ose pengesa e parë për t'u tejkuluar është në rrafshin psikologjik pasi zakonisht kahu i përkthimit është nga gjuha e huaj drejt gjuhës mëmë duke mos i shpëtuar pyetjes: Por, si ka mundësi që të përktheni drejt gjuhës së huaj? Duket gati si një “mëkat deontologjik” i atyre që përkthejnë në një gjuhë që nuk është e tyre.

Ngurrimi është i kuptueshëm. Është më e lehtë dhe më e zakonshme, siç përmendëm më lart të përkthehet nga “zbarkosh” tekstin në gjuhën amtare, aty ku familjariteti dhe ndërjegjësimi konjitiv

janë rrënjësor që në vitet e para të jetës. Por një kontekst italoofil, që nxitet nga afërsia dhe kontekste të ngjashme, mund të jetë i përshtatshëm për ndryshimin e kahut të përkthimit. Prandaj mund të themi vetëm se procesi i përkthimit, po të përdorim metaforën e detit, ishte si një udhëtim me varkë dhe në të cilin ti, përkthyesi, ndihesh si një rremtar që përpiqet ta shpjerë përmbajtjen semantike në gjuhën e synuar, duke shpresuar se ngarkesa do të mbetet e paprekur pasi siç thotë Pol Valeri, *të përkthesh do të thotë të prodhosh me mjete të ndryshme efekte të ngjashme*.

Ndonjëherë deti është i qetë dhe kjo e bën të lehtë punën e përkthyesit, udhëtimin e tij gjuhësor drejt bregut tjetër. Herë të tjera deti është i trazuar dhe përkthyesit i duhet të mësojë të lundrojë në ato ujëra, duke punuar, hulumtuar, duke u konsultuar me kolegët, duke shkruar dhe rishkruar. Janë valë që ngjallin frikë, por duhet të mësosh të lundrosh mbi to, duhet t'u bësh ballë baticave dhe zbaticave. Përkthyesi duhet të jetë në gjendje t'u bëjë ballë distancave gjuhësore nga të cilat fillimisht mund të fillojë ta shquajë realitetin e të tjerëve, më pas t'u hedhë një vështrim, mandej ta shohë dhe pastaj gradualisht ta këqyrë, vëzhgojë, zhbiriolojë dhe në fund ta përpunojë atë.

Sipas Catford “*përkthimi mund të përkufizohet si zëvendësimi i materialit tekstual në gjuhën burimore me material ekuivalent në gjuhën e synuar*”<sup>3</sup>.

Por për mendimin tonë akti i përkthimit nuk është një shkrepje fotografike përmes së cilës shija e kuptimeve dhe nuanca mund të bartet nga një gjuhë në tjetrën në mënyrë identike, por është një proces përpunimi i vazhdueshëm që paraqet shumë vështirësi ku kompetenca gjuhësore e përkthyesit sprovohet sa herë që ai përpiqet t'i qëndrojë besnik tekstit origjinal.

Të përkthyerit e Otellos donte të thoshte të ndjeje një farë afërsie me autorin dhe personazhet, me mënyrën e tyre të të sjellurit, mënyrën e të parit dhe të shprehurit, të përvetësoje vizione apo këndvështrime që nuk i dinim se ekzistonin më parë dhe që tani e tutje do të na shoqëronin *përgjithmonë. Pra, më së shumti do të thoshte të ndjeje dhe përktheje EMOCIONE*.

Nuk përkthyes nuk mund të jetë indiferent ndaj asaj që heq Otello, nuk mund të mos e urrejë Jagon për të gjitha intrigat e tij, nuk mund të mos e dojë Desdemonën e Blushit ose mos t'i vijë keq për zemërgjërësinë e pamatë të Emilisë ndaj të tjerëve, sidomos ndaj Jagos.

Dhe problemi i përkthimit, *Jagoja ynë*, është pikërisht përkthimi i aspektit kulturor, dërgimi i tij në brigjet e gjuhës së huaj, asaj italiane. Ky aspekt është më i vështiri për t'u përcjellë, veçanërisht për ata që nuk përkthejnë në gjuhën e tyre, por nga gjuha e tyre.

Le të sjellim një shembull nga paragrafi i mëposhtëm **MAGRITTE**

[... Pas tij, për të plotësuar detajet e një përralle të vërtetë, vinin disa dhjetëra **krushq**, të veshur me jelekë të zinj dhe me shpata në formë kryqi. Në fund të këtij karvani ishin gjashtë karroca të mbuluara me pëlthurë të gjelbër, në të cilat ishin futur gratë dhe **peshqeshet e dasmës...**]<sup>4</sup>

[...Dopo di lui, come per dare il tocco finale ai dettagli di una vera fiaba, seguivano alcune decine di **paraninfi**, vestiti con gilet neri e spade a forma di croce. In fondo a questa carovana c'erano sei carrozze coperte di stoffa verde, dentro alle quali stavano le donne e i **doni di nozze...**]<sup>5</sup>

3 Catford, J. C. (1965): A linguistic Theory of Translation. London: Oxford University Press.

4 Ben Blushi, “*Otello, Arapi i Vlorës*”, Ben Blushi & MAPO editions, Tiranë, 2011, fq. 320.

5 Ben Blushi, “*Otello, il Moro di Valona*”, Mimesis Edizioni, Milano-Udine, 2018, fq. 280.









DIALOGU I NËNTË  
AKTORJA DHE KONTI

*Dhoma e gjumit e aktores. E mobiluar me luks. Është dymbëdhjetë e mesditës; grila errësuese e brendshme e dritares është ende e ulur; mbi komodinën e natës flakëron një qiri, aktorja është ende e shtrirë në shtratin e saj me tendë. Mbi mbulesën e krevatit gjenden shpërndarë gazeta të shumta.*

*Konti hyn me uniformën e një kalorësi të armatosur lehtë. Ndalon te dera.*

AKTORJA  
Ah, zoti kont.

KONTI  
Mamaja juaj më lejoi, përndryshe s'do të isha...

AKTORJA  
Ju lutem, uluni.

KONTI  
Ju puth dorën. Ndjesë... kur hyn nga rrugët këtu... errësira... s'po shoh dot gjë prej gjëje. Atëherë... ja këtu... (te shtrati) Ju puth dorën!

AKTORJA  
Uluni, zoti kont.

KONTI  
Mamaja juaj më tha: "Zonjusha ndihet pa qejf... Shpresojmë të mos jetë diçka serioze".

AKTORJA  
Asgjë serioze? Isha afër vdekjes!

KONTI  
Për hir të Zotit, si është e mundur?

AKTORJA  
Gjithsesi, më gëzon fakti që mundoheni të më vizitoni.

KONTI  
Në prag të vdekjes! Ju mbrëmë luajtët si perëndeshë.

AKTORJA  
Ishte vërtet një triumf i madh.

KONTI  
Madhështor!... Njerëzit mbetën të gjithë të magjepsur. Sa për mua, as që dua ta përmend.

AKTORJA  
Ju falënderoj për lulet e bukura!

KONTI  
Ju lutem, zonjushë!

AKTORJA  
(Tregon me sy drejt një shporte të madhe me lule, mbi një tavolinthë të vogël pranë dritares.) Ja ku janë.

KONTI  
Ju dje, në kuptimin e vërtetë të fjalës, u mbuluar me lule dhe kurora.

AKTORJA  
Ato ndodhen ende në gardërobën time. Vetëm shportën tuaj solla në shtëpi.

KONTI  
(I puth dorën.) Një gjest i ëmbël prej jush.

AKTORJA  
(Papritmas ia merr dorën dhe ia puth.)

KONTI  
Por... zonjushë.

AKTORJA  
Mos u frikësoni, zoti kont, kjo s'ju detyron për asgjë.

KONTI  
Ju jeni një krijesë e mahnitshme... mund të thuhet thuajse enigmatike. (Heshtje.)

AKTORJA  
Mendoj se zonjusha Birken është një problem më i lehtë për t'u zgjidhur.

KONTI  
Po, e vogla Birken s'është problem, edhe pse... e njoh veç kalimthi.

AKTORJA  
Oh!

KONTI  
Besoni. Por ama ju jeni një problem dhe unë kam pasur përherë dëshira për probleme. Ka qenë e gjitha një humbje e madhe për mua që nuk ju pashë të luanit më parë.

AKTORJA  
Vërtet?

KONTI  
Po. Shkuarja në teatër, zonjushë, është e komplikuar për mua. Jam mësuar të ha darkë vonë... kështu që kur arrin atje, një pjesë e mirë ka mbaruar. Apo s'është kështu?

AKTORJA  
Atëherë që tani e tutje do të hani më herët.

KONTI  
Po, edhe këtë e kam menduar. Ose mos të ha fare. Nuk është vërtetë ndonjë kënaqësi ngrënia, jo.

AKTORJA  
Çfarë kënaqësie tjetër ka një plakush si ju?

KONTI  
Për këtë e pyes veten shpesh! Por ama plak nuk jam ende. Duhet të ketë një arsye tjetër.

## VALLJA REIGEN

nga Arthur Schnitzler

Komedi në dhjetë dialogë

Shqipëroi Loreta Schillock

AKTORJA  
Besoni?

KONTI  
Po. Lulu,<sup>1</sup> për shembull, thotë se jam filozof. E dini, zonjushë, ai mendon se unë zhytem thellë në mendime.

AKTORJA  
Po... të menduarit, kjo është fatkeqësi.

KONTI  
Kam shumë kohë, prandaj dhe mendoj thellë. Ju lutem, zonjushë, shihni, mendova, nëse më transferojnë në Vjenë, do të jetë më mirë. Këtu ka argëtim, gjallëri. Por në thellë nuk është ndryshe nga atje lart.

AKTORJA  
Ku është "atje lart"?

KONTI  
Atje poshtë, e dini, zonjushë, në Hungari, në atë humbëtitë, ku unë kam qenë zakonisht me shërbim.

AKTORJA  
Çfarë keni bërë në Hungari?

KONTI  
Siç jua përmenda, zonjushë, shërbim.

AKTORJA  
Po pse qëndruat kaq gjatë në Hungari?

KONTI  
Gjërat ndodhën si ndodhën...

AKTORJA  
Ama duhet të jetë diçka që të bën të çmendesh.

KONTI  
Përse? Preokupime, në fakt, ka më shumë këtu sesa atje. E dini, zonjushë, stërvitje rekrutësh, kalërim me Remonte<sup>2</sup>... e kështu që s'mbetet kohë për shëtitje, siç thuhet. Realisht është vërtetë diçka e bukur, rrafshnalta; dhe një perëndim i tillë dielli... është për të ardhur keq që s'jam piktor. Ndonjëherë mendoj me vete: sikur të isha piktor, do ta pikturoja. E kishim një në regjiment, një farë Splani të ri. Dinte të pikturonte... Eh, ç'historira të mërzitshme po ju rrëfej, zonjushë.

AKTORJA  
Oh ju lutem, po kënaqem shumë.

<sup>1</sup> Emri është në fakt Loulou: rrjedh nga frëngjishtja dhe është formë përkëdhelëse e emrit Louis ose Louise. Përdoret edhe në kuptimin: shpirt, zemërushe.

<sup>2</sup> Remonte: rrjedh nga frëngjishtja dhe përdoret për kuajt të rinj të ushtrisë; është një term i përdorur në stërvitjen klasike të kalërimit.

## Arthur Schnitzler VALLJA REIGEN



Shqipëruar nga Loreta Schillock **RL BOOKS**

KONTI

A e dini, zonjushë? Gjëja më e bukur me ju është që mund të bisedohet këndshëm, e dija këtë nga Lulu dhe kjo është diçka që gjendet rrallë.

AKTORJA

Natyrisht, atje poshtë në Hungari, apo jo?

KONTI

Kështu është dhe në Vjenë! Njerëzit janë të njëjtë kudo; ku ka më shumë, është dhe rrëmuja më e madhe, veç ky është ndryshimi. Më thoni, zonjushë, ju pëlqejnë vërtet njerëzit?

AKTORJA

A më pëlqejnë? I urrej! S'shoh dot me sy askënd dhe as që shoh kurrë ndonjë. Jam gjithmonë vetëm; në këtë shtëpi nuk hyn askush.

KONTI

E shihni, e mora me mend, që i urreni njerëzit. Në art duhet të ndodhë shpesh kjo. Kur jeton në zonat e larta... të paktën jeni me fat që e dini pse jetoni!

AKTORJA

Kush jua tha këtë? As që e kam idenë se përse jetoj!

KONTI

Vërtet zonjushë? Të jeni e famshme... e kërkuar...

AKTORJA

Është kjo lumturia?

KONTI

Lumturia? Ju lutem, zonjushë, lumturia nuk ekziston. E pikërisht ato gjëra, mbi të cilat flitet më gjerësisht, nuk ekzistojnë... për shembull, dashuria. Edhe ajo nuk ekziston.

AKTORJA

Këtu keni të drejtë.

KONTI

Kënaqësia... dehja... edhe mundet, askush nuk i mohon... sepse vërtet ekzistojnë. Tani, kur kënaqem... e di se po kënaqem. Ose kur jam i dehur, prapë bukur. Edhe kjo është e sigurt që ekziston. Dhe kur gjithçka merr fund, thjesht merr fund.

AKTORJA

(Madhërisht.) ...merr fund!

KONTI

Por kur dikush nuk jepet, si mund ta them më mirë, sapo të mos i dorëzohet momentit... domethënë kur dikush mendon për të ardhmen apo të shkuarën... gjithçka mbaron në një çast, në çast. Më vonë... ka trishtim... më herët ka mëdyshje... me një fjalë... mund të humbësh fillin, të hutohesh. A nuk kam të drejtë?

AKTORJA

(Pohon me sy të zgurdulluar.) Siç duket e keni gjetur kuptimin e gjithçkaje.

KONTI

E shihni, zonjushë, sapo qartësohesh për këtë çështje, s'ka rëndësi nëse jeton në Vjenë apo në Puszta<sup>3</sup> apo në Steinamanger<sup>4</sup>. Për shembull... ku mund ta lë pak kapelën? Ah po, faleminderit... ku e kishim fjalën?

AKTORJA

Për Steinamanger.

KONTI

Korrekt. Atëherë, siç thashë, ndryshimi nuk është aq i madh. Nëse në mbrëmje ulem në kazino apo në klub, është e njëjta gjë.

AKTORJA

Po për dashurinë, ç'mund të thuhet?

KONTI

Nëse beson në të, gjithnjë do gjendet dikush që do të të dëshirojë.

AKTORJA

Si për shembull, zonjusha Birken?

KONTI

Nuk e kuptoj, zonjushë, pse e sillni gjithnjë bisedën tek ajo zonjë e vogël?

AKTORJA

Është dashnorja juaj, apo jo?

KONTI

Kush e thotë këtë?

AKTORJA

Të gjithë e dinë.

KONTI

Përveç meje, për çudi.

AKTORJA

A nuk luftuat në një duel për shkak të saj?

KONTI

Ndoshta... edhe më vranë, por nuk e kam vënë re.

AKTORJA

Zoti kont, ju jeni një zotëri i vërtetë; pse nuk uleni më afër meje?

KONTI

Me kënaqësi.

<sup>3</sup> Hungarisht Puszta: krahinë me livadhe të gjëra në Hungari.  
<sup>4</sup> Qytet provincial hungarez, shtrihet në perëndim të Austrisë dhe nuk ndodhet shumë larg Vjenës.



AKTORJA  
Ja këtu! (*E tërheq pranë vetes, i shkon me dorë nëpër flokë, me përkëdhelje.*) E dija që do të vinit sot!

KONTI  
Si e dinit?

AKTORJA  
E dija që dje në teatër.

KONTI  
Më patë që nga skena?

AKTORJA  
Zgjohuni, zotëri! A nuk e vutë re se luajta vetëm për ju?

KONTI  
Jo! Si është e mundur?

AKTORJA  
Fluturova kur ju pashë të ulur në radhën e parë!

KONTI  
Fluturovat...? Për hir tim...? Nuk kisha as idenë më të vogël që më vutë re!

AKTORJA  
Edukata juaj aristokratike është boll për të më bërë të ndihem e dëshpëruar.

KONTI  
Por, zonzushë...

AKTORJA  
"Por, zonzushë"... Të paktën hiqeni shpatën tani!

KONTI  
Nëse më lejoni?! (*E heq dhe e mbështet në shtrat.*)

AKTORJA  
...dhe më jepni një puthje, më në fund.

KONTI  
(*E puth, ajo e mban fort.*)

AKTORJA  
Do kish qenë më mirë të mos ju kisha parë kurrë!

KONTI  
Mua më duket më mirë kështu.

AKTORJA  
Zoti kont, ju jeni një pozues i vërtetë!

KONTI  
Unë? Pse e thoni?

AKTORJA  
Sa i lumtur, mendoni, do ishte gjithkush në vendin tuaj?

KONTI  
Po. Ndhim vërtet i lumtur.

AKTORJA  
Mendova se lumturia nuk ekziston. Pse më shihni ashtu? Besoj se keni frikë nga unë, zoti kont!

KONTI  
Jua thashë zonzushë, ju jeni një problem.

AKTORJA  
Oh, më lini në paqe me filozofinë tuaj... ejani tek unë. Dhe tani mund të kërkoni ç'të doni... mund të keni gjithçka që dëshironi... Jeni kaq tërheqës.

KONTI  
Atëherë, mund të kërkoj lejen tuaj, (*duke i puthur dorën*) që të rikthehem te ju sot në mbrëmje.

AKTORJA  
Sot... por sonte jam prapë në skenë.

KONTI  
Pas shfaqjes.

AKTORJA  
Dhe nuk doni asgjë tjetër?

KONTI  
Për të tjerat do lutem pas teatrit.

AKTORJA  
(*E fyer.*) Mund të luteni sa të doni atëherë, ju i mjeri pozues.

KONTI  
Mirë, por... kemi qenë kaq të singqertë me njëri-tjetrin deri tani... mendoj se do ishte shumë më bukur në mbrëmje pas teatrit... më rehatshëm se tani, ku... se pse kam një ndjesi sikur nga çasti në çast do hapet dera...

AKTORJA  
Nuk hapet nga jashtë.

KONTI  
Zonzushë, mendoj se s'është mirë ta prishësh me mendjelehtësi para kohe diçka që ndoshta mund të jetë shumë e bukur.

AKTORJA  
Ndoshta!...

KONTI  
Të them të vërtetën, dashuria në mëngjes më duket diçka e tmerrshme...

AKTORJA  
Atëherë, jeni me të vërtetë krijesa më e marrë që kam njohur!

KONTI  
S'po flas për femrat në përgjithësi... në fund të fundit, përgjithësisht kjo s'ka fare rëndësi. Por gratë si ju... jo, mund të më quani njëqind herë të marrë. Por gratë si ju... nuk shijohen para mëngjesit. Kështu... e dini... kështu...

AKTORJA  
O Zot, sa i ëmbël që jeni!

KONTI  
E kuptoni atë që thashë, apo jo? E përfytyroj sikur...

AKTORJA  
Më thoni, si e përfytyroni?

KONTI  
Ja kështu... ju pres në karrocë pas shfaqjes. Pastaj shkojmë së bashku për darkë, diku...

AKTORJA  
Nuk jam zonzusha Birken unë!

KONTI  
Nuk e thashë një gjë të tillë. Thjesht mendoj se çdo gjë vjen me atmosferën e duhur. Në rastin tim nuk jam kurrë në qejf para darke. Më e mrekullueshmja është kur pas darkës udhëtojmë së bashku për në shtëpi, atëherë...

AKTORJA  
Atëherë, çfarë?

KONTI  
Atëherë... varet nga rrjedha e mbrëmjes...

AKTORJA  
Ejani, uluni këtu afër. Më afër.

KONTI  
(*Ulet në shtrat.*) Më duket se nga jastëkët kundërmon diçka si... minionetë, apo jo?

AKTORJA  
A nuk mendoni se është shumë vapë këtu?

KONTI  
(*Përkulet dhe i puth qafën.*)

AKTORJA  
Oh, zoti Konti, po kjo është kundër programit tuaj.

KONTI  
Kush foli për programe? Unë s'kam ndonjë program.

AKTORJA  
(*E tërheq pranë vetes.*)

KONTI  
Është vërtet nxehtë.

AKTORJA  
Vërtet? Dhe kaq errësirë, si t'ishte mbrëmje... (*E tërheq ngjitur vetes.*) Është mbrëmje... është natë... Mbyllini sytë, po qe shumë dritë për ju. Ejani...! Ejani...!

KONTI  
(*Nuk kundërshton më.*)



AKTORJA  
Si të duket atmosfera tani, pozues?

KONTI  
Ti je një djall i vogël.

AKTORJA  
Ç'është kjo që më thua?

KONTI  
Mirë atëherë, një engjell i vogël.

AKTORJA  
Duhet të ishe bërë aktor! Vërtet! Ti i njeh mirë gratë! E di se çdo bëj tani?

KONTI  
Çfarë?

AKTORJA  
Do të të them se nuk dua të të shoh më kurrë.

KONTI  
E përse?

AKTORJA  
Kurrë më! Je shumë i rrezikshëm për mua! Ti e bën femrën të çmendet. Tani, qëndron këtu para meje, sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

KONTI  
Por...

AKTORJA  
Mos harro, zoti kont, sapo ju dhashë gjithçka.

KONTI  
S'do ta harroj kurrë!

AKTORJA  
Po për sonte mbrëma, si do bëjmë?

KONTI  
Në ç'kuptim?

AKTORJA  
Pra, doje të më prisje pas shfaqjes së teatrit...?

KONTI  
Ah po, le të themi, për shembull, pasnesër.

AKTORJA  
Ç'do të thotë kjo, pasnesër? Ishte fjala për sot.

KONTI  
Sot s'do kishte shumë kuptim.

AKTORJA  
Eh, plakush!

KONTI  
Nuk po më kupton. Dua të them se ka të bëjë, më shumë se me gjithçka tjetër, me shpirtin.

AKTORJA  
E ç'më intereson shpirti yt?

KONTI  
Më beso, ka shumë rëndësi. Jam i mendimit se është e gabuar kjo mënyrë e jotja e ndarjes...

AKTORJA  
Më lër në paqe me filozofinë tënde. Nëse dua diçka të tillë, e lexoj në libra.

KONTI  
Nga librat s'mësohet kurrë.

AKTORJA  
Kjo është e vërtetë! Prandaj duhet të më presësh sot në mbrëmje. Për sa i përket shpirtit, do biem në një mendje... ti maskara!

KONTI  
Mirë, nëse më lejoni, do pres në karrocën time...

AKTORJA  
Jo, do presësh këtu në shtëpinë time...

KONTI  
...pas shfaqjes.

AKTORJA  
Natyrisht.

(*Konti rivendos shpatën.*)

AKTORJA  
Ç'po bën?

KONTI  
Mendoj se është koha të largohem. Si për një vizitë joformale më duket se ndenja paksa gjatë.

AKTORJA  
Atëherë, sonte në mbrëmje le të jetë vizitë formale.

KONTI  
Ashtu?

AKTORJA  
Ma lër mua të kujdesem për këtë. Dhe tani më jep edhe një puthje, ti filozofi im i vogël. Pra, o joshës... o i ëmbli vogëlush... o tregtar shpirttrash, o panterë. (*Pasi e puth fort disa herë, e largon me forcë.*) Zoti kont, ishte një nder i madh për mua!

KONTI  
Ju puth dorën, zonzushë! (*Te dera.*) Mirupafshim.

AKTORJA  
Tungjatjeta dhe të fala Steinamangerit!

E mërkurë, 11 shtator

Qysh se jam emëruar me punë këtu, s'më ka ndodhur të kaloj natë më të keqe. Një angushti ma largonte gjumin, por pa ma hequr krejtësisht. E kam vënë re se këto janë netët më të këqija, kur gjumi as të vjen, as të ikën, po rri aty mënjanë si për të të sflitur.

Sikur të mos mjaftonte kjo, herë-herë më dukej se nga deti vinte një rënkim. Dytri herë u ngrita dhe përgjova në dritare. S'ndihej asgjë, veç kur shtrihesha rënkimi përsëritej.

Zot, psherëtiva, çliromë nga këto parandjenja të liga dhe u luta me përdëllim si rrallëherë. Disi i qetësuar nga lutja, më tepër ndoshta prej agut që po afronte, më në fund, aty ndaj të gdhirë më zuri gjumi.

Gjatë ditës qepallat i kisha të rënda plumb. Dy herë shefi më tërhoqi vërejtjen gjatë përpilimit të kumtesës për kapjen e një sasive kripe kontrabandë në anijen "Jupiter". Megjithëse është njeri tekanjor, duhet të them se këtë herë kishte të drejtë. Më e keqja ishte se nuk dija si ta përligjja mefshtësinë time. T'i thosha se gjatë natës nuk kisha fjetur fare, ngaqë më bëhej se dëgjoja rënkime nga deti, kishte rrezik të më merrte për të lajthitur.

E shtunë, 14 shtator

Breg i detit plot me leshterikë ngjyrëkafë të nxjerra nga valët e dy ditëve të fundit. Shkumë që formohet e shpërbëhet në një përsëritje lodhëse përpara syve të mi. Përsëri kontrabandë, këtë herë stofrash. Zhbirime, gjobitje, kumtime për qendrën.

Njëllor si javën që shkoi. Njëllor si javën tjetër përpara kësaj. A mund të ketë njëtrajtshmëri më topitëse se kjo?

Përpara një muaji, kur më ngarkuan edhe me një detyrë të veçantë: matjen çdo ditë të temperaturës së ujit, furisë së dallgëzimit, si dhe shpejtësinë e erës dhe drejtimin e saj, m'u duk se diçka do ta thyente mërzinë e ditëve. Por nuk ndodhi ashtu. Ato më shtuan vetëm kokëçarjet.

E martë, 17 shtator

Udhëtarë të një anijeje që vinte nga Shqipëria dhe që ndaloj gjysmë dite, sa për të marrë ujë, sollën që andej lajme të këqija. Kështjellat shqiptare po bien njëra pas tjetrës. Me sa duket, së shpejti gjithçka do të marrë fund atje. Thuhet se kryeqyteti i vendit, Kruja, ka rënë ndërkaq dhe se së shpejti do të bjerë Shkodra. Një murg venedikas, me të cilin bisedova vetë, më tha se ka të ngjarë që pranverën që vjen turqit të nisin sulmin e madh kundër krejt Europës. Dhe Italia jonë do të jetë e para që do të bjerë. Duhet të jesh i verbër që të mos e shikosh këtë, kështu më tha. Flitet se sulltani i tmerrshëm i turqve, Mehmeti i dytë, paska deklaruar se pasi e ka kthyer Shën Sofinë e Kostandinopolit në xhami, nuk pret veçse pranverën për ta lidhur kalin e tij te portali i kishës së Shën Pjetrit në Romë.

U llahtarisa nga gjithë këto.

E shtunë, 21 shtator

Dje më hoqën vërejtjen lidhur me shënimet e temperaturave dhe të erës që, sipas kërkesës së qendrës, i kisha dërguar atje. I kishin gjetur jo fort të plota e të sakta.

Gjithë natën s'më zuri gjumi. Vrisja mendjen të gjeja nëse ishin vërtet të pakënaqur nga kjo, apo s'ishte veçse një shkas për të më hequr qafe. Ky mendim i fundit sa ç'm'u duk bindës në krye, aq më ngjau qesharak pastaj. E kush do ta lakmonte këtë punë të trishtueshme, buzë këtij bregu gati të shkretë, ku togjet e leshterikëve, me atë ngjyrëkafë jotokësore, i ngjajnë një makthi?

Kështu e qetësova veten njëfarësoj, megjithëse shqetësimi më rifilloi shumë

# SHËNIME NGA KAPITANERIA E PORTIT

## Tregim nga Ismail Kadare



shpejt. Në qoftë se nuk ishte kjo, atëherë ç'ishte shkaku i pakënaqësisë? T'u ishin dukur vërtet të tilla, domethënë të pasakta, shënimet e mia, kjo ishte krejt e pabesueshme. Kush e mori vesh ftohtësinë e ujit dhe lartësinë e dallgëve në këtë breg të nëmur, para tridhjetë ditësh, para njëzet e nëntë ditësh, e kështu me radhë, që na paska dërguar matjet e tij të fshehta, të cilat, pasi qenkan krahasuar me të mia, na i paskan nxjerrë, këto të fundit, si jo fort të sakta?

E aq më tepër po të mendosh punën e erës, e drejtimin dhe e furisë së saj... Është vërtet për të luajtur mendsh e gjithë kjo.

Po ne jse. Kohët e fundit, përgjithësisht punët e mia po shkojnë mbrapsht dhe s'kam pse ta marr aq fort për zemër këtë mbrapshti të re.

E hënë, 23 shtator

Anije tjetër nga Durrësi i Shqipërisë. Limani më i madh i vendit është në krahurë të plotë. Atje nën mbrojtjen e Venedikut janë mbledhur një pjesë e familjeve të princave e baronëve shqiptarë, që po thyhen njëri pas tjetrit në kështjellat e tyre fatkeqe.

Ndonëse Venediku ka premtuar mbrojtjen e tyre, ata ndodhen në alarm të vazhdueshëm. E sikur turqit, pa pyetur traktate e marrëveshje, t'i sulen një ditë qytetit?

Atë punën e kalit të sulltan Mehmetit te portali i kishës së Shën Pjetrit ma dha një tjetër udhëtar sot. Ç'tmerr.

E enjte, 26 shtator

Ujë i njelmët, që herë më duket më shumë i ftohtë e herë më pak, brezare dallgësh që thërrmohen me zhaurimë në vija të shtrembra, me kreshta të paqëndrueshme. Dhe erë. Erë që fryn herë në një drejtim, herë në tjetrin, që e ndërron drejtimin papritur, sipas trilleve

të saj, pa lënë gjurmë kurrkund. Kurse unë gjurmoj si i shastisur të gjitha këto dy herë ditën, në mëngjes dhe në muzg, "në orët e çmendurisë", siç i quaj me vete.

Po të vazhdoj edhe ca muaj, në mos u çmendsha, kam për të rrjedhur me siguri.

E mërkurë, 2 tetor

E mora vesh më në fund shkakun e interesimit aq serioz për ato që më dukeshin si punë të kota, domethënë për ujin, dallgët dhe erën.

Dje erdhën nga kryeqyteti një grup njerëzish, gjysmë civilë, gjysmë ushtarakë, që u vërtitën gjithë ditën në breg të detit. Vizituan malin e vjetër, depot e ujit e të doganës, pastaj i ranë me këmbë ranishtes së shkretë përtej skelës, hetuan zhavorrin, shkëmbinjat, madje disa shpërvolën petkat e u futën në ujë, ndonëse ujët ishte akull.

Aty nga pasditja u mor vesh arsyeja: këtu mendohet të ngrihet një port i madh ushtarak. Matanë detit, në tokën shqiptare tashmë të pushtuar, turqit paskan nisur zgjerimin e një baze të vjetër detare bizantino-shqiptare, për ta përdorur si pikënisje në sulmet e tyre kundër krishterimit europian. Kështu ia paskan vënë edhe emrin "Pasha-Liman", që në gjuhën e tyre do të thotë: Pashai i Limaneve, si të thuash Liman i parë ose Liman Gjeneral.

Si kundërpeshë për këtë, monarkët e krishterë të Europës kanë vendosur të ngrënë këtu limanin e tyre të mbrojtjes. Madje thonë se pak a shumë edhe emrin ashtu do ta ketë "Porto Princeps". Pra, do të jetë jo vetëm si pasqyrimi i tij në këtë breg, por edhe emnaku i tij.

Siç duket, të dhënat e mia, për të cilat (Zot i madh, dridhem tani kur i kujtoj), kam shfryrë kaq herë, duke i quajtur trille të çmendurish, për këtë qenkan kërkuar.

E martë, 8 tetor

Sot mbërriti anija e parë me refugjatë shqiptarë. Jo vetëm nëpunësit e portit, por gjithë gjindja që ndodhej në rrugët përreth u sulën në mol për t'i parë.

Pikëllimi që sillnin me vete dukej që larg. Dorëzat e arkave të rënda, stolitë e grave, madje dhe kopsat e veshjeve spërndritnin që tej, si të qullura nga lotët.

Pastaj kur u afruan, pamë sytë e tyre dhe ata ashtu ishin: plot me lot. Ca lot të rëndë që ndihej menjëherë se rridhnin mbi lot të vjetër, të thatë, ashtu siç kishin rrjedhur edhe këta të fundit. Perëndi, të çahet zemra dysh tek i shikoje.

Kishin dalë për t'i pritur përfaqësues të mbretit Alfons të Napolit, aleatit të madh të Skënderbeut, i cili thuhej se do t'u jepte të gjithëve toka dhe prona në mbretërinë e tij.

Pikërisht për këtë flisnin njerëzit, ndërsa dërguesit ecnin drejt qerreve që i prisnin më tej. I lumtë mbretit Alfons. Gjithsesi duhej ta bënte, ata janë heronjtë e Europës, martirët e saj. Ashtu është, është më e pakta gjë që mund të bëhet për ta: t'u jepet një copë truall në kontinentin për të cilin u flijuan. Për Perëndi, e the mirë: një copë Europë për ata që e humbën atë përjetë. E tani si mund të quhet Shqipëria? Shqipëria... s'di ç'të them, ajo tani u bë... moskund... ose Azi... si mund të quhet tjetër? Ajme, ç'mjerim!

Midis soditësve gjendeshin shkularakë shqiptarë të ardhur këtu tridhjetë e ca vite më parë, kur lufta sapo kishte nisur. Janë kryesisht oficerë të gjymtuar, që pasi u shtruan në spitalet tona, nuk u mëkëmbën dot. Një pjesë kanë krijuar familje, por të shumtë janë ata që shpresuan më kot të kthehen. Tani, tek shohin të shembet shpresa e fundit, s'u mbetet veç t'ia marrin asaj kënge të trishtë, ndoshta më e pikëlluara këngë e botës, që këndohet tani gjithandej. Një ditë ia kam shënuar fjalët:

*O e bukura Shqipëri**Që kur të lashë më s'të pashë.**Atje kam unë zotin tatë,**Atje kam unë zonjën mëmë,**Atje kam vëllezërit krejt,**Gjithë të shtrirë nënë dhe...*

E premte, 11 tetor

Mot i keq. Ngaqë gjithë kohës kam përpara syve rrokullimën e pareshtur të suvalave, ajo më ndjek edhe në ëndërr. Ca ëndrra të mundimshme, që të lënë në mëngjes shijen e rrënimin. Ndoshta fundbotat kështu e dërgojnë qysh më parë pamjen e tyre në trurin e fjetur të njeriut.

Ka ca ditë që valët, për shkak të kreshtave të shkumës, më ngjajnë si me çallma, nga ato që mbanin dikur hebrejntë (së paku kështu i kam parë në piktura), e që tani thonë se i mbajnë turqit.

E hënë, 14 tetor

Prapë anije nga Shqipëria. Dhe prapë lotëri tejet e pikëlluar në sytë, në karficat dhe unazat e ikanakëve, sidomos të grave.

Te tremet, përsëri ndërtesës së doganës, një grumbull kureshtarësh ndiqnin me sy e me fjalë zbritjen e të ardhurve.

Këta duhet të jenë nga familja e dukës së Gjinit, thoshte dikush.

E nga i ditke ti me kaq hollësi vulat e shenjat e senjorëve shqiptarë? e pyeste një tjetër.

Njeriu të cilit iu drejtua pyetja vështroi habitshëm, me ca sy të trembur, sikur çdo gjë mund të priste nga gjindja përreth, përveç asaj pyetjeje.

I di ai, i di, u hodh një i tretë. Ka qenë kaq herë me shërbim në Shqipëri dhe këto gjëra i di ndoshta më mirë se shqiptarët vetë. Meqë ra fjala, iu drejtua njeriut që porsa kishte marrë në mbrojtje, ti na ke thënë se luani i kurorëzuar është shenjë e kontëve Topija.



Poezia pasuron imagjinatën tonë, ushqen ëndërrimet tona duke qendruar në zemër të asaj që quhet njerëzore. Ajo vështron pareshtur mbi botë dhe në pafundësinë e ndjesive dhe mbresave për të zbuluar misteret e jetës përmes ligjërimit të poetit. Madame de Staël mendonte se poezia « duhet të pasqyrojë bukurinë e botës ». Kurse Victor Hugo thoshte se poeti « është një botë e mbyllur te një njeri i vetëm ».

Duke qenë se poezia i jep në mënyrë paqësore raportet etike të njeriut me botën që në ballinën e broshurës së Festivalit, veç titullit *Zërat e gjallë të Mesdheut*, lexohet edhe nëntitulli : *Poezia, udha e paqes*.

« Të mbrosh poezinë, të ndërtosh hapësira të atilla, në mënyrë që ajo t'u transmetohet sa më shumë njerëzve, kjo nuk resht së qeni një përpjekje e fortë në botën e sotme që i lë kaq pak vend zërit të poetëve », shkruan në fjalën hyrëse të librit-program të Festivalit, Maïthé Vallès-Bled, drejtore e Festivalit poetik.

Ndjeshmëria e poetëve gdhendet në artin e poemës. Ata transformojnë bukurinë apo tragjedinë në ligjërime duke vënë në dukje, duke pyetur dhe u përgjigjur, duke u mahnitur. Dikur besohet se poeti frymëzohet nga Muzat, por në botën moderne është shpirti poetik që flet. Paul Valéry, poet dhe eseist me një refleksion intelektual të jashtëzakonshëm, profesor i poetikës në Collège de France, thoshte se « Poeti përkushtohet dhe tretet që të përkufizojë dhe ndërtojë një ligjërime brenda ligjërimit ». Edhe poeti ynë kombëtar Naim Frashëri kur shkruan vargun «*Do të tretem, të kullohem*», në poemën *Fjalët e qiririt*, jep idenë e përkushtimit fatal të poetit në shoqëri. Poeti vendoset në qendër të një universi me një intimitet që vjen duke u zbuluar. Mjaft herë ai konstaton se ky intimitet është i kërcënuar dhe duhet mbrojtur.

\*\*\*

Të shkruarit poetik është një lloj « aventure orfike » siç e quan poeti francez Luc (Luk) Vidal, i cili bënte pjesë edhe në grupin e atyre që paraqitnin poetët e huaj. Vidal drejton shtëpinë botuese *Petit Véhicule* në të cilën janë botuar edhe disa poetë shqiptarë.

Pasqyrë që heton ligjërimit, një ligjërime që banohet prej një energjie të misterhme, poema ngallmon në brendësi të saj bukurinë e gjuhës në lëvizje. Në Antologjinë e Festivalit, botuar nga shtëpia botuese Bruno Doucey, e cila përmban nga një poemë të poetëve të ftuar, në gjuhën amtare dhe të përkthyer frëngjisht, ndihet kjo muzikë e gjuhëve dhe alfabetëve duke krijuar kështu një poemë të gjatë që përshkon një horizont të pakufishëm. Në poemën Çengeli i ëndrrave, Claudio (Klaudio) Pozzani, poet italian, ndër të tjera, shkruan : « *Unë e shkoj jetën duke pritur diçka / Një avion, një tren, një aventurë, vdekjen / Në mëngjes, trupi im del nga errësira [...] / Unë e shkoj jetën time nëpër një sitë të dendur / Nuk u flas njerëzve që s'më japin gëzim [...] »*

\*

Leximi i poemave nga poetë të ardhur nga vende të ndryshme të mesdheut si : Algjeri, Egjipt, Francë (kuptohet që Franca si vend i madh organizues do të kishte një përfaqësime të gjerë), Greqi, Irak, Itali, Izrael, Palestinë, Portugali, Rumani, Spanjë, Shqipëri etj., në orë të ndryshme dhe në pika të ndryshme që përfshinin pjesën kryesore të këtij qyteti, në skena natyrore qarkuar me shezlongë dhe karrige, të krijonin idenë e një skene të madhe me një auditor të gjerë që qarkullon ide, dialogë, emocione. Dukej sikur poemat vinin së largu dhe brofnin me jehona krejt të lira, mes vërshimit ligjërimit duke e lënë imagjinatën e dëgjuesve të përshkonte hapësira të panjohura. Gjuha e tyre, herë e druajtur dhe herë e harlisur, e zotëronte plotësisht skenën.

Lidhja e poetit me kohën dhe me vendin e vet është gjë e natyrshme, thuajse biologjike, sepse çdo njeri është bir i kësaj toke, në kuptimin e drejtëpërdrejtë, por edhe metaforik të fjalës. « Të gjitha gjërat kanë misterin e tyre, por poezia është misteri i mistereve, thotë Federico Garcia Lorca .



*Nga datat 22 deri në 30 korrik 2022 në qytetin Setë të Francës, i quajtur edhe qyteti ku panë dritën e jetës Paul Valéry dhe Georges Brassens, u zhvillua Festivali poetik Zërat e gjallë të Mesdheut (Voix Vives de Méditerranée).*

# DITËT POETIKE TË SETËS

nga Feride Pappleka

Të ndiesh, të vësh re, ta shprehësh atë që është për t'u transmetuar dhe të shkruash vetëm kur ke diçka për të thënë, diçka që del nga zemra, nuk është mision i thjeshtë. Në poemën *Kush*, poetja rumune disidente Ana Blandiana thotë : « Unë jam / si / një kokërr rëre / që / bëhet kohë / vetëm / kur bie.

Festivali, me anë të fjalës poetike të drejtpërdrejtë me skena të improvizuara në natyrë, dëshmoi përpjekjen e poetëve për të dhënë kuptimet e vetvetishme, origjinën, shpresën dhe dashurinë si vlera të përjetshme. Prandaj, duket sikur poezia hyn rëmbimthi në gjuhë dhe në botë që të tregojë gjithashtu të vërtetat e pathëna, vuajtjet që sjell lufta, trishtimin, dashurinë, vetminë. Ajo është një zë i kumbueshëm i një realiteti njerëzor që nuk pajtohet me mediokritetin dhe të keqen. Një ndjesi e hollë regjistrohet kështu në fjalët që lëshohen në qiellin e shpirtrave dhe në faqen e shkruar. Është një

dritë e përqendruar që kërkon të mblidhet për t'u shpërndarë pastaj kudo me të njëjtën forcë për të ngjallur emocione estetike.

\*

Dita niste me lexime poemash dhe me lexime poemash mbaronte. Ato i interpretonin frëngjisht aktorë të shkëlqyer me përvojë skenike si Patrick Vendrin, Olivia Nicosia, Arthur Combelles dhe Charlotte Dumoulin.

Krahas leximit, gjatë ditëve të Festivalit poetik, u trajtuan edhe tema të ndryshme rreth krijimit dhe përkthimit, por temat e të qenit poet, e rolit të tij si zë jetësor i së vërtetës dhe ekzistenca e njeriut në shoqëri, zunë vendin kryesor. Jeta e poetit është një tërësi mbresash dhe përgjigjesh që formojnë lëndën e veprës së tij, e cila është njëkohësisht një copëz e jetës së njerëzimit


me vuajtjet e me dhimbjet, me çastet e saj sublime e me çastet e rënda. Ndërgjegjja e poetit duhet të shkojë deri në shtresat më të thella të ekzistencës. Seferis, poet noblist grek, thotë : « ... megjithatë unë nuk dua të shoh te poeti një të papërgjegjshëm, të rrëmbyer nga vala e frymëzimit apo e çudirave, përkundrazi unë besoj se një artist me vlera është një nga qeniet më të ndërgjegjshme të planetit ». Poeti është në kërkim të përhershëm për të zbuluar në botën që na rrethon, idetë që e përshkojnë dhe e trazojnë mendjen dhe shpirtin e njeriut për ta bërë jetën më të mirë dhe botën më të jetueshme.

\*

Poema nxjerr në pah fijet e holla që bashkojnë zemrat me anë të artit poetik. Është një hapësirë që ka ngjyra të ndryshme, por që brenda secilës ngjyrë gjenden fjalë dhe vargje që rigjejnë jetën në lëvizje. Falë kësaj lëvizjeje njeriu merr pjesë në ristrukturimin e një bote mbase të humbur, por që dëshmon për energjinë e mekanizmit të gjuhës që çon dejt një bote të ftuar. Gjithsesi, a mund të thuhet se është botë e ftuar kur ekziston lufta ? Kësaj pyetjeje dramatike i përgjigjet poetesha siriane që i ka ikur luftës absurde në vendin e vet dhe ka emigruar në Spanjë, me këto vargje : « Në luftë / Plumbi konkuron / Me të sapolindurin / në gjirin e mëmës ». Ndërsa poeti algjerian Yvan Tetelbom, në poemën *Liria* e shpreh revoltën e tij ndaj luftës kështu : « Këtë mëngjes, në Kiev, / Dielli ishte mbuluar / Me njolla të çuditshme / Ngjyrë balte [...] » etj. Një shkrimtar i njohur thotë se « Ana e pasme e modernitetit ka pamjen e saj të errët », në të cilën çdo ditë përjetohen drama kolektive, familjare, apo vetjake : me mijëra njerëz vriten në luftëra absurde, mijëra të tjerë detyrohen të zhvendosen duke u bërë refugjatë në vendin e vet, apo shkojnë gjetiu, ndahen prindërit nga fëmijët, fëmijët jetojnë pa fëmijëri, gruaja nuk zë vendin e merituar si e barabartë në shoqëri etj. Pastaj, racizmi, antisemitizmi, urrejtja fetare, ndërkufitare... Poezia e përshkon edhe këtë rrugë të hidhur.

Jo rrallë herë duhet « Të organizosh kaosin », shkruan poeti amerikan Wallace Stevens.

Leximet e përditshme në vende të ndryshme të qytetit, si dhe në *Place des Livres (Sheshi i librave)*, ku përveç skenës



së leximit ishte edhe salloni i madh, i librit poetik, i hapur në natyrë, i mbuluar me çadra të bardha, në të cilin shtëpi të ndryshme botuese të poezisë, me qendër në Francë, por edhe në vende të tjera të Mesdheut, në mënyrë që dëgjuesi edhe mund të blinte librin e tij. Gjithçka ishte si një ushtrim i bukur, që kërkoi tërë disiplinën e mundshme. Skena në natyrë i ngjante një skene të vërtetë me paraqitësin, poet, kritik, apo gazetar francez, i njohur që më parë me lëndën poetike të autorit, aktorin që do të interpretonte poemat frëngjisht; autori i huaj i lexonte ato në gjuhën amtare; mjetet teknike të zërit dhe të regjistrimeve i realizuan vullnetarë të rinj, gjimnazistë, ardhur nga qyteti Toledo i Spanjës. Të mos harrojmë edhe vullnetarët e tjerë që sillnin ujë në seancat e leximit dhe panelin ku ishte shkruar emri i poetit dhe i vendit nga vinte, shoferët që i shoqëronin në mbrëmje në vendet ku flinin, për të plotësuar kështu sadopak mozaikun e punëve të shumta e të domosdoshme në shërbim të mbarëvajtjes së Festivalit.

Këngët dhe tingujt muzikorë ishin të pranishëm gjatë leximit të poemave ose pas leximit të tyre; instrumentistë dhe këngëtarë të mirënjohur si Roula Safar, Diego La Onda, Marie Di Iorio, Althaea Sciocca, Mark Simon e të tjerë ishin pranë poetëve për t'i dhënë veprimtarisë më shumë larmi.

Në Festival u shpalosën disa lloje poemash si ato me varg të lirë, strofike, haiku, ode, sonet, poema tingullore, poema të realizuara me gjeste etj. Një vend të veçantë zuri edhe poema me gjuhën e shenjave, e cila këto vitet e fundit ka njohur një zhvillim të veçantë. Ajo dëftoi aftësinë për t'u integruar e asaj kategorie të shoqërisë që i mungon komunikimi: të folurit apo të dëgjuarit, apo edhe të dyja. Gjuha e shenjave është një gjuhë e tërë e shprehur nga njerëz tepër të ndjeshëm dhe këmbëngulës për t'u përshtatur në shoqëri. Në poemën e tij *Gondol* që interpretoi me gjuhën e shenjave, poeti francez Victor Abou, ndër të tjera, thotë: « Sheshi San Marco / Një tufë e madhe zogjsh / largohen dhe i magjepsin vështrimet tona / Që ndjekin valët e ndritshme dhe gondolën krenare [...] ».

\*

Koha e Festivalit u mbush me veprimtari që nisnin në orën 10 00 të paradites dhe përfundonin natën vonë, gjer në orën 23 00 ose 24 00. Këto skena të vogla të fjalës poetike, çdo ditë i dhuronin diçka të re publikut. Dhe sado që në pika të ndryshme të qytetit, në të njëjtën orë mund të kishte lexime nga autorë të ndryshëm, gjithnjë kishte dëgjues, madje disa herë poeti e gjente « auditorin » me njerëz që e donin poezinë dhe që e prisnin. Midis tyre kishte edhe shqiptarë. Një nga ata ishte edhe Abdyl Blakçori, i cili ishte vendosur në Setë prej vitesh dhe zhvillonte një veprimtari ekonomike të sukseshme duke ndihmuar edhe mërgimtarë të tjerë nga Shqipëria. Ky Festival, të cilin ai e ndiqte me interes, kishte ngjallur dashurinë për poezinë, e cila ishte tek ai një pasion i hershëm.

Festivali, që kishte shtrirje të gjerë si kohë dhe pjesëmarrje me poetë, botues, gazetarë, aktorë dashamirës të poezisë, orkestrantë dhe këngëtarë, i pasur me veprimtari të shumta ditore, pati një organizim të përsosur. Në mesazhin e falënderimit dërguar njëjës prej organizatoreve të Festivalit unë përdora shprehjen tashmë të njohur se aty gjithçka punoi si orët zvicerane dhe e krahasova Festivalin me një anije (mbase ishte « anija e dehur » e Arthur Rimbaud-së) dhe drejtoreshën e Festivalit Maïthé Valles-Bled, si një kapitene e sprovuar, e karakterizuar nga një qetësi dhe seriozitet i rrallë, me dy ndihmëset e palodhura Laurence dhe Marie-Hélène. Ishte vërtet një përgjegjësi e madhe të drejtoje atë organizim me përfshirje të gjithanshme.

Në natën e mbylljes së Festivalit ashtu si në natën e hapjes së tij, poetët e ftuar lexuan nga një poemë duke i dhënë kështu karakterin e një shfaqjeje gjigante të veprimtarisë poetike.

Qyteti mesdhetar Setë përjetoi ato ditë një festë madhështore.

Tiranë, gusht 2022

Shënime për vëllimin poetik "Në orën moderne të Perëndive"

# Relievi poetik i Nurie Emrullait

Nga Ndue Ukaj

Shkrimtari J. L. Borges tek eseu "Poezia" thotë "ne e ndjejmë poezinë, ashtu sikurse e ndjejmë afërsinë e një femre ose sikur e ndjejmë aromën e maleve apo thellësinë e detit." Duke e lexuar poezinë e Nuries – ose më mirë të them – duke e shijuar atë, më kujtohet Borges dhe mendimet e tij për poezinë. Në fakt, sa herë ndodhem përballë qenies së poezisë, horizonteve që hap ajo, hamendem nëse duhet apo jo të flitet për të.

Por ja që është zakoni i vjetër që ndonjëherë të themi diçka për leximet, përshtypjet, qoftë edhe për t'i shërbyer konceptit antik të ndërmjetësimit.

Relievi poetik i Nuries është një botë e madhe, me ngjyra të shumta, ku ajo hedh shikimin dhe kundron jetën dhe të njëjtën e shpalos përballë lexuesve, duke qëndruar në këmbë të lodhura, në të cilat jetojnë shpirtëra të shumtë, dëshira zhuritëse e plagë të kohës, por edhe të historisë. Këto vëzhgime poetike, ajo i përpunon përmes gjuhës e figurës, dhe duke i lidhë fort mendimin e figurën.

Dhe merita e madhe poetëve u takon ngaqë ata kanë guximin që shumë ndjesi, trandje shpirtërore, trazime, ëndrra, gjakime, të vërteta të heshtura, t'i nxjerrin nga skutat e errëta të shpirtit dhe t'i hedhin në dritë lakuriq, që bota t'i sheh dhe të mësojë nga to. Dhe, mënyra sesi ata e bëjnë këtë është e bukur, madje edhe kur subjekti i poezisë është i mbushur me trishtim, në orët moderne të Perëndive, kur:

"Ne nuk e dimë në sa metra katror jetohe këtu?"

Në sa metra katror vdiset, e dimë.

Dhe poetja e shkund lexuesin, sepse i dëfton se:

*"Secili e ka një vend të humbur në botë, Secilin e gjen në fund ai."*

*Dhe poetja e ka gjetë rrugën si shkohet e gjallë vdekjes në një kohë të pagëzuar moderne, kur ëndërrimtarë për dashurinë janë vetëm ca të thinjur.*

*Ka humbë kaq shumë njeriu?*



Në poezinë "Udhëtar", poetja ka dëshirë të udhëtojë dhe lutet nga forcat supreme ta çojnë atje:

*"Të shkoj atje, ku gjallë është dashuria, dhe veç prej saj çelin frutet, e jo nga frika mos vjeshtohen degët vetëm."*

Në këto trajektore jete, ku tjetërsimi ngjan të jetë ngarendje e botës bashkëkohore, poetja flet për të pathënat e një jete ose të jetës, shqetësohet për vlera fisnike e superiore, që lartësojnë shpirtin dhe botën e bëjnë më humane. Dhe vëzhgimet e saj janë të mbrehta, vargjet goditëse, siç ngjet te poezia "Karantinë":

*"Kam frikë mos bota merr rrugën e gabuar, gjithë nocionet e dashurisë janë vjetruar."*

Nëse poetët janë legjislatorë të panjohur të botës sonë, siç thotë Percy Bysshe Shelley, atëherë shqetësimet e poetes tingëllojnë si kambana alarmi, siç janë poezitë e kujtesës apo ato mbijetesës, ngaqë siç dëfton poezia:

*"Kur e tashmja breddh këndeji, pihen barnat e vetmisë, të dehur nga liria, robërinë të gjithë harrojnë."*  
(Fati i mbijetesës)

Ose:  
*"Lëngun e ditëve të vetmisë e pimë në gota uji.*

*Nuk zbrazet asnjëherë. Jemi mësuar të themi: mjafton! pas dy-tri glënjëkave.*  
(Mbamendje)


Dhe kjo mbase ngjet ngaqë:  
*"Gjithë ditën mësojmë të harrojmë kush jemi.*  
*në të tjerë njerëz zhysim kokën, në të tjera realitete fusim këmbët."*

E, përballë këtyre realiteteve, ku tkurrja shpirtërore është e madhe, te poezia e bukur "Aureolë" poetja kërkon vetë dhe i kërkon tjetrit të zhvishet për të treguar jehonën e shpirtit, meqë:

*"Botës varja, bota është miope, bota s'do t'ia di për ne, as për zë e shpirt. Gjaku është ujë për të e trupi zgavër."*

Poetja nuk i frikësohet rritjes dhe këtë ia kërkon edhe lexuesit të saj, njëkohësisht për t'i dëftuar se urrejtjen dhe dashurinë gjuha di t'i ndajë dhe si një kronikane që depërton skutave të errëta të jetës, ajo ia shpalos botës veten, autoportretin, gjakimet, dëshirat, dhimbjet, nëpër orët e vona të pritjes e ikjes, në kohën e lumturisë apo në çastet e trishtimit dhe gjithçka e mbështjell me gjuhë të bukur, varg të qartë dhe kulturë letrare.

Poezia e Nuries transmeton energji, thnegla dashurish dhe ndërton një kështjellë plot dritë, jetë, gjallëri e dashuri për veten e universalen, për veten e të tjerët, në të cilat raporte, poezia shpaloset e bukur, e hijshme, plot jetë dhe dashuri.



WALRAVENS: Cili ishte kontakti juaj i parë me botën e artit?

MAGRITTE: Kur isha shumë i ri, kisha qejf të ngjyrosja imazhe. Por bota e artit m'u shfaq gjatë pushimeve të kaluara në një qytet të vogël provincial. Në varrezën e vjetër të papërdorur të këtij qyteti pashë një piktor që po praktikonte artin e tij dhe aty më erdhën ideja e parë se cila mund të ishte bota e artit.

WALRAVENS: Si, më 1921 reaguat ndaj ekspresionizmit?

MAGRITTE: Më 1921 isha i ndarë mes dëshirës për të pikturuar si kubistët, futuristët, piktorët tradicionalë dhe abstraktë. Teoritë e tyre – të cilat, normalisht, kundërshtonin njëra-tjetrën – më tërhiqnin fort, pavarësisht thatësisë së tyre. Gjeta në to elemente që u përgjigjeshin preokupimeve të mia intelektuale të asaj kohe. Por më 1921 ekspresionizmi më la shpërfillës. Teoricienët e tij nuk e kapën dot interesin tim. Sidoqoftë, nuk besoj se një teori e ekspresionizmit mund të jetë e vlefshme për të gjithë. Ekspresionizmi, në fakt, është vetëm një përgjigje ndaj një ndjesie të caktuar shtrembërimi dhe thjeshtëzimi të cilin unë nuk e ndaj.

WALRAVENS: A kam të drejtë të them se gjatë këtyre viteve keni pikturuar piktura abstrakte?

MAGRITTE: Duke qenë se gjatë atyre viteve jam përpjekur të pikturoj në stile të ndryshme, kam pikturuar gjithashtu piktura që mund të quhen "abstrakte". Por ishte thjesht një çështje kërkimi që mund të kënaqte dëshirën time për të pikturuar në një mënyrë që lidhet më pak me pikturën dhe më shumë me vetë botën.

WALRAVENS: Si u lidhët me surrealistët francezë kur jetonit në Belgjikë?

MAGRITTE: Takimi im me surrealistët francezë ndodhi rreth vitit 1926, pas një shkëmbimi korrespondencash mes grupit dhe disa miqsh në Bruksel të cilët mendonin si unë. Gjithashtu, jetova në Paris nga viti 1927 deri më 1930 dhe kjo më mundësoi të shkoja në takimet ku André Breton ishte "deus ex machina".

WALRAVENS: Si ishte surrealizmi në ato vite?

MAGRITTE: Që nga fillimi surrealizmi ishte thelbësisht ai që është sot: ideja se jeta e njeriut duhet absolutisht t'ia vlejë të jetohet. Kjo ide është e papajtueshme me dorëheqjen (me ose pa vetëdije) nga banaliteti dhe mundësitë e pakësuar të një konceptimi i cili u nënshtrohet të ashtuquajturave nevojshmëri.

WALRAVENS: A e njihnit veprën e Freud-it në atë kohë?

MAGRITTE: E kisha lexuar veprën e Freud-it nga afër në kohën kur ishte lirshëm në dispozicion. Por nuk mund



të interesohem në analizën e çfarëdo realiteti, edhe nëse analiza është e zgjidhur në mënyrë brilante sipas predikimeve të Freud-it.

WALRAVENS: A dëshironi të na tregoni një anekdotë mbi temën e André Breton-it?

MAGRITTE: Ndërkohë që kureshtia e mendjeve shkencore i kthehet diçkaje të panjohur e cila i korrespondon një teorie, André Breton e adhuronte të panjohurën për hir të së panjohurës, jo të një të panjohurë të parashikuar si një objekt dije, që do ta shpërbente në diçka të njohur. Breton nuk shkruan për të krijuar vepra letrare, por për të përforcuar idenë se jeta duhet absolutisht t'ia vlejë të jetohet.

WALRAVENS: Po Paul Éluard?

MAGRITTE: Éluard shkroi: "Sytë më të errët mbyllin më të ndriturit." Ai mundi të evokonte një realitet të pandarë nga

misteri i tij – ky mister i cili nuk rrjedh nga asnjë doktrinë. Ky mister me të cilin nuk mund të krahasohet asgjë, dhe pa të cilin asnjë mendim dhe asnjë botë s'do të ishte e mundur.

WALRAVENS: Cilët surrealistë francezë – përveç këtyre të dyve që përmendët – kanë pasur ndikim më të madh te ju?

MAGRITTE: Mendoj se Marcel Duchamp është një surrealist francez shumë i rëndësishëm: ka treguar se si objekte tejet banale mund të marrin një hijeshi të çmuar, falë modifikimeve fare të vogla: për shembull, në Paris ai mbyll një shishe e cila nuk mban asgjë veç ajrit dhe mbi këtë shishe ai ngjiti një etiketë me mbishkrimin: AJËR PARISI.

Por duhet të them De Chirico, i cili është italian, dhe Max Ernst, me origjinë gjermane, janë piktorë veçanërisht angazhues. Së fundmi, e vetmja gjë që mund të thuhet për Dalí-në, është se ka gjetur në surrealizëm mjetet për

të shpërndarë një aktivitet në të cilin vetëm budallenjtë mund të jenë të interesuar.

WALRAVENS: Pse u kthyet në Bruksel?

MAGRITTE: Për arsye të thjeshta e praktike, po aq të parëndësishme sa mund të jenë arsyet për lëvizjen nga një qytet tek tjetri.

WALRAVENS: Çfarë mendoni për surrealistët belgë?

MAGRITTE: Duhet të përmendim surrealistët belgë Camille Goemans dhe Paul Colinet, të dy kanë vdekur kohët e fundit. Nuk donin të quheshin "figura letrare"; nuk ishin të interesuar në letërsi – as surrealistët. Goemans ka shkruar poezi dhe ese të cilat dëshmojnë një prani të jashtëzakonshme të mendjes. Colinet dinte sekretin e një humorit të ngrohtë e shqetësues. E.L.T. Mesens ka shkruar poezi të cilat japin një hijeshi enigmatike. Scutenaire shkruan aforizma të cilët e vendosin lexuesin para përgjegjësi të çuditshme. Marcel Lecomte di se si është e këshillueshme të flasësh një gjuhë të pashprehshme. André Bosmans tregoi se ishte një poet i vërtetë: ka forcën kureshtare që e mundëson ta quajë veten "njeri të letrave" pa na turpëruar. Ai mendon se "asgjëja është e vetmja mrekulli e botës". Më në fund, doja të përmendja Nougé, një shkrimtar, prania në tokë e të cilit na kujton se "çdo gjë është ende e mundur" dhe se "ne jemi përgjegjës për universin". Sa për piktorët belgë të cilët e quajnë veten surrealistë, janë më të interesuar në pikturë sesa surrealizëm. Veprat e tyre thjesht japin dëshmi të një nënshtimi ndaj zakoneve artistike të cilave surrealistët me të drejtë u janë larguar. Këto zakone shkojnë dorë për dorë me një konfuzion të dukshëm intelektual – konfuzion, për shembull, mes fantazisë dhe poezisë.

WALRAVENS: Çfarë, sipas mendimit tuaj, është surrealia dhe pse duhet piktura, arti i ngjyrës dhe formës, të shqetësohet për të?

MAGRITTE: Surrealia nuk duhet ngatërruar me dëshirën për një botë imagjinare. Imagjinaria është një karikaturë e poezisë. Kur ndodh diçka e mrekullueshme, kur shfaqet poezia, nuk është çështje imagjinate apo mungese imagjinate. Për shembull, duhet mentalitet kazerme për të përdorur fjalën imagjinatë kur flet për një tregim si "Bukuroshja e fjetur". Kënaqësia jonë në leximin e rrëfimit nuk është imagjinare – dhe kjo kënaqësi e vërtetë nuk duhet ndarë nga tregimi i bukuroshes së fjetur. Surrealia, ose surrealiteti, është realiteti i zhveshur nga banalja apo kuptimi i jashtëzakonshëm i lidhur me të. Surrealia është realiteti i cili nuk është ndarë nga mister i tij. Piktori surrealist përshkruan mendimin i cili mund të bëhet i dukshëm përmes pikturës. Ky mendim evokon misterin, misterin pa të cilin asnjë mendim apo botë nuk do të ishte i mundur.

**WALRAVENS:** Cilat janë karakteristikat kryesore të përmbajtjes psikike të veprës suaj?

**MAGRITTE:** Pikturat e mia janë mendime të dukshme. Këto mendime formohen vetëm nga figura që më ofron bota. Këto mendime sillen bashkë për të evokuar mister. Koncepti im për artin e pikturës nuk konsiston në trajtimin e një teme në një mënyrë origjinale apo të çuditshme. Është çështje e zbulimit të diçkaje të cilën mund ta përshkruash me sa më shumë saktësi të mundesh.

**WALRAVENS:** Pse pikturoni në *trompe l'oeil*?

**MAGRITTE:** Sepse *trompe l'oeil* më lejon t'i jap imazhit të pikturuar shprehinë e thellësisë së botës së dukshme dhe sepse piktura ime duhet t'i përngjajë botës në mënyrë që të evokojë misterin e saj.

**WALRAVENS:** A ka ngjyra në veprën tuaj, fuqinë e saj shprehëse?

**MAGRITTE:** Në disa prej pikturave të mia, ngjyra shfaqet si një element mendimi. Për shembull, një mendim i përbërë nga trupi i një gruaje i cili ka të njëjtën ngjyrë si qielli blu [*La Magie noire*]. Në piktura të tjera, ngjyra duhet t'i bëjë format e pikturuara të ngjajnë më shumë si forma në botën e dukshme. S'është nevoja të thuhet se ngjyra – edhe nëse është çështje e qiellit blu – vjen në pikturë për të lartësuar ngjashmërinë me botën, por, gjithsesi, mund edhe ta pëlqesh ngjyrën e qiellit për atë që është.

**WALRAVENS:** Si lidhen titujt dhe subjektet e pikturave tuaja?

**MAGRITTE:** Titulli është i lidhur me figurën e pikturuar në të njëjtën mënyrë që figurat janë të lidhura me njëra-tjetrën. Këto figura bashkohen në një mënyrë që sjell mister. Titulli bashkohet me imazhin e pikturuar sipas të njëjtin rend. Për shembull, piktura *La Mémoire* tregon një fytyrë allçie me njollë gjaku në të. Kur i dhashë pikturës këtë titull, ndjeva që shkonin mirë bashkë. Mund të flitet për pikturën dhe titullin e saj. Unë do të përpiqem të mos flas përçart.

Por fillimisht më duhet të them se kur pikturova *La Mémoire* nuk po mendoja atë që do të them tani. Mendova vetëm për harmonizimin e imazhit dhe titullin që emëron imazhin. Rrjedhimisht, piktura nuk është ilustrimi i ideve në vijim: kur themi fjalën "kujtesë", e shohim se përputhet me imazhin e një koke njeriu. Nëse kujtesa mund të zërë hapësirë, mund të jetë vetëm brenda kokës. Pastaj, njolla e gjakut mund të na sugjerojë se personi të cilit i shohim fytyrën mund të jetë viktimë e një aksidenti fatal. Së fundmi, është çështje e një ndodhie në të shkuarën e cila qëndron në të tashmen në mendjen tonë falë kujtesës.

**WALRAVENS:** Surrealistët deklarojnë se surrealizmi është një art revolucionar. Pse?



**MAGRITTE:** Pa një mendim revolucionar kundërvënë rregullave pak a shumë arbitrare që na janë imponuar, surrealizmi nuk do të mundte t'i jepte vlerë supreme idesë se jeta e njeriut duhet absolutisht t'ia vlejë të jetohet.

**WALRAVENS:** Si përgjigjeni kur ju akuzojnë se jeni pikturor letrar?

**MAGRITTE:** Që një pohim i tillë është gabim vulgar. Nëse ka diçka të tillë si pikturë joletrare apo madje dhe antiletrare, atëherë është pikërisht ajo

që po përpiqem të bëj. Vërtet, piktura ime nuk shpreh asnjë ide apo ndjenjë. Këtë ua lë shkrimtarëve, të cilët kanë një gjuhë në dispozicion, të aftë për të komunikuar idetë dhe ndjenjat. Idetë dhe ndjenjat nuk kanë një formë të dukshme e cila mund të përfaqësohet në pikturën time. Piktura ime është thjesht një përshkrim (pa origjinalitet ose fantazi) i një mendimi, referencat e vetme të të cilit janë figurat në botën e dukshme. Këto figura janë të bashkuara në një rend që nuk mund ta lënë askënd shpërfillës. Por ato nuk janë përgjegjëse për idetë dhe ndjenjat që shfaqen kur i shohim.

**WALRAVENS:** Çfarë gjëje thelbësore mendoni se i ka sjellë surrealizmi kulturës moderne?

**MAGRITTE:** Nga njëra anë, surrealizmi dënoi disa vlera false të cilat nënkuptonin se një numër i jashtëzakonshëm gomarllëqesh deklarohesh se ishin të nevojshme për jetën e mendjes, për vetë jetën. Progresi në art kënaq disa shpirtra të thjeshtë të cilët e bëjnë qëllimin e jetës së tyre. I jepen me mish e me shpirt një bote që është absurde dhe e privuar nga efektiviteti. Nga ana tjetër, surrealizmi eliminoi simbolet në nder të asaj që simbolizonin simbolet. Surrealizmi i ka sjellë kulturës idenë se jeta nuk duhet të jetë në shërbim të artit, e të asgjëje, por që asgjë nuk ka ndonjë vlerë shpirtërore nëse na lë shpërfillës.

**WALRAVENS:** Çfarë mendoni për artin bashkëkohor?

**MAGRITTE:** Përveç De Chirico dhe Ernst, nuk njoh asnjë pikturor bashkëkohor i cili ka sadopak idenë e një pikturë e cila nuk është ndikuar nga zakonet intelektuale të cilat më lënë shpërfillës.

**WALRAVENS:** A i ëndërroni ndonjëherë pikturat tuaja?

**MAGRITTE:** Nuk kam ëndërruar kurrë piktura për t'u pikturuar. Bota nuk më vjen në gjumë teksa ëndërroj. Nuk mund ta "shoh" një pikturë nëse nuk jam tërësisht i zgjuar dhe kam, për më tepër, prani të përsosur të mendjes. Nuk e kam atë prani të mendjes kur jam në gjumë.

**WALRAVENS:** A keni ndonjë pikturë të parapëlqyer mes veprave tuaja, dhe pse?


**MAGRITTE:** Nuk kam asnjë të parapëlqyer. Mund të ketë dallim vetëm nëse mund të bësh një krahasim. Tani, për të krahasuar pikturat e mia do të thotë të jesh i pavetëdijshëm për *raison d'être* të tyre. Secila prej pikturave të mia evokon diçka e cila nuk mund të krahasohet me asgjë tjetër: misterin që nuk rrjedh nga asnjë doktrinë, mister pa të cilin asnjë botë apo mendim s'do të ishte i mundur.

Marrë nga René Magritte:  
*Selected Writings*  
Përktheu Enxhi Hudhri





SHOQATA  
E BOTUESVE  
SHQIPTARË



ME MBËSHËTJETJEN  
E BASHKISË SË DURRËSIT

# Festivali Veror i Librit Durrës

17-21 GUSHT 2022



*Me det me Librin*

Me mbështetjen  
e Ministrisë së Kulturës



ORA 19:00-23:00, NË SHËTITOREN TAULANTIA